



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”

Institucioni i Arsimit të Lartë

“Universiteti Epoka”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof As. Etleva Leskaj

Prof As. Etleva Bajrami

Mars 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"

| | | |
|----|---|--|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "EPOKA" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Administrim Biznesit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave "Administrim Biznesi" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 908, datë 26.08.2009 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | Shkresë e MASH nr. 527/1 prot, datë 31.05.2011 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër MAS nr.214, dt. 24.10.2022 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA Nr. 60, datë 28.09.2018 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 Vite/4 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 Kredite (ECTS) |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha Angleze |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | Viti 2022-2023: 14 PAE/ 3 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | Viti 2022-2023: nr. 32 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznes është një program i ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë i cili ofrohet nga Universiteti Epoka. Ky program studimi është licensuar me VKM Nr. 908, datë 26.08.2009. Akreditimi i pare me Urdhër Nr. 286, datë 06.07.2012 (kohezgjatja 6 vite). Akreditimi periodic eshte bere me VBA Nr. 60, datë 28.09.2018 (kohezgjatja 5 vite, me afat 30.09.2023). PS MSH ne AB ka 120 kredite të cilat janë të ndara në të kater semestra. Marrja e të gjitha krediteve i jep mundësinë studentëve të paisen me diplomën që ofron ky program studimi.

Për arritjen e misionit dhe objektivave të këtij programi, njësia përgjegjëse për ofrimin e tij ka hartuar kurrikulat të cilat do të mundësojnë paisjen e studentëve me njohuritë thelbësore të menaxhimit si dhe aftësi menaxheriale.

Programi i studimit MSHAB ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit. Departamenti i cili është përgjegjës për programin është një departament i konsoliduar dhe me një staf pedagogjik të brendshem dhe të jashtëm me eksperiencë në mësimdhënie e me grada shkencore duke u konsideruar si garant për plotësimin e standarteve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UE, shpejgohen qartë dhe në mënyrë të detajuar qëllimet e programit, objektivat e tij, të cilat perputhen plotësisht me nevojat për punësim, kërkesat e tregut të synuar, apo nevojat dhe mbështetjen që institucioni i bën biznesit dhe entiteteve vendase në sektorin publik edhe atë privat, përmes këtij program.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 06.22.2022, Universiteti Epoka ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi". ASCAL bazuar në manualin "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit", përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm të cilët bazuar në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) si dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), të programit të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" të Universiteti Epoka dhe në vizitat e kryera në këtë institucion, kanë hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi". Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën 2 ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të KPSC, etj.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof. Asoc.Dr. Etleva Leskaj dhe Prof.Asoc.Dr. Etleva Bajrami. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL, Znj Rajna Lila. GVJ-së ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga UE(DVV) në datën 22.06.2023, pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni nga GVJ, u hartua dhe agjenda e vizitës në institucion, të cilat u zhvilluan në datat 6 dhe 7 korrik 2023, në ambientet e institucionit. Gjatë vizitave ekspertëve ju vendos në dispozicion një sallë e dedikuar për të kryer takimet e planifikuara sipas agjendës. Ndërkohë që u kërkua dhe dokumentacion shtesë i cili ju vu në dispozicion GVJ. Bazuar në DVV, në intervistat me pyetje të përcaktuara të GVJ, sipas fokus grupeve të përcaktuara në agjendë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm paraqet Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të programit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi". Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Në përfundim të këtij Raporti, paraqitet në forme të përmbledhur një analizë përfundimtare mbi programin e studimit Master i Shkencave në "Administrim Biznesi", si dhe rekomandimet përkatëse për institucionin.

Shkalla e përmbushjes së rekomandimeve, të lëna nga akreditimi i fundit:

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit bazuar në Vendimin Nr.60 datë 28.09.2018 janë:

- 1. Institucioni, të rishikojë shpërndarjen e ngarkesës mësimore për uljen e numrit të lëndëve që mbulon cdo pedagog dhe /ose rritjen e numrit të stafit akademik, për ti mundësuar stafit të kryejë aktivitetet kërkimor dhe administrativ.**

GVJ konstaton se, rekomandimi është plotësuar, referuar planit mësimor të programit si dhe shpërndarjes së ngarkesës mësimore në program dhe jashtë programit, duke mundësuar 1 lëndë për cdo pedagog në MSHAB. Gjithashtu rezultoi shtimi i stafit të departamentit me tre anëtarë të rinj me gradën doctor i shkencave, çfarë sjell ulje të ngarkesës së stafit aktual dhe një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore dhe numrit të lëndëve. (Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf; Annex 45. BUS Action Plan in Response to the Recommendations.pdf)

- 2. Institucioni, të hartoj kritere përgjithsisht të standardizuara për vlerësimin e dijeve të studentëve dhe të garantojë zbatimin e tyre për të gjitha lëndët/modulet e programit**

GVJ është e mendimit se rekomandimi është plotësuar. Referuar këtu kurrikulës së programit, ku konstatohen kriteret e vlerësimit të standardizuara.

(Annex 47. The curriculum of the study program.pdf; Annex 4. Syllabuses.pdf)

Më datë 08.02.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 122 Prot., Datë 08.02.204, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 133/20 Prot, Datë 14.02.2024.

Komentet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, për Programin e Studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”, Universiteti Epoka

GVJ duke vleresuar komentet e Institucionit, percjell qendrimin rreth tyre si me poshte:

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

GVJ ne draft RVB eshte shprehur: Programi i studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e detyrimeve përmbyllëse.

Neni 42 i Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë, në rastin e Masterit Shkencor nëse studenti merr 120 kredite ECTS, ai merr Diplomen në Master Shkencor.

Plani mësimor për programin e studimit i dhënë në tabelat e vëna në dispozicion nga institucioni në Tabelat përmbledhëse i paraqet lëndët të ndara sipas tipit të veprimtarisë.

Si Lëndë bazë është vetëm një lëndë me 7.5 kredite ECTS që përbën 6.25% të krediteve.

Në cdo semester plani mësimor ka nga 2 lëndë të detyrueshme, të cilat janë lëndë bazë ose karakterizuese (6 në total), duke pasur kështu 7.5 ECTS nga lënda bazë dhe 37.5 ECTS nga lëndët karakterizuese.

Cdo semestër ka 2 lëndë me zgjedhje, 6 në total. Për të përzgjedhur 2 lëndët me zgjedhje në semestrin e parë studentët ka 10 mundësi nga të cilat 2 janë lëndë karakterizuese. Në semestrin e 2 për të zgjedhur 2 lëndë janë 7 mundësi nga të cilat 3 janë lëndë karakterizuese. Në vitin e 2 për të zgjedhur 2 lëndë janë 8 mundësi të cilat janë lëndë karakterizuese, duke bërë që të 4 lëndët të jenë karakterizuese dhe në total kreditet e lëndëve karakterizuese janë minimum 60 ECTS, që përbëne 50% tëtotalit të krediteve dhe plotësohet kriteri 50-55% i Lëndëve karakterizuese.

Nga planet mësimore rezulton se totali i krediteve të veprimtarive A dhe B janë jo më pak se 60% në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.

Gjatë vizitës në institucion GVJ ju komunikua se studentët orientohen në përzgjedhje, gjë që parashikohet në nenin 20 të Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë.

Mikroteza (Tema e diplomës) ka 30 kredite ECTS. Plani mësimor nuk ka Praktikë Profesionale.

GVJ sygjeron të përcaktohen më shumë lëndë të detyrueshme. Programi I studimit përfshin 12 lëndë nga të cilat 6 të detyrueshme, dhe stabiliteti në vijimësinë e kurrikulës së Masterit nga njëri vit në tjetrin është jo I sigurt.

Qendrimi i GVJ mbi Komentet e institucionit:

Pasi lexuam komentet e GVB, vlerësojme rishikimet dhe përditesimet e përvitshme të kurrikulës dhe praktiken që ndiqet. GVJ sygjeron të përcaktohen më shumë lëndë të detyrueshme. Standardi II.1, Kriteri 3 nuk ndryshon

Standardi IV.1

Kriteri 3: Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

GVJ në draft RVB është shprehur: GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin e DVV, në tabelën 6 tek Tabelat Përmbledhëse, konstaton se për tre vitet e fundit, qarkullimi i stafit është 35%, pothuajse i njëjtë ky qarkullim si në PAE dhe në PAK. Referuar DVV si dhe vizitës në institucion, në dosjet e stafit, rezultojnë kontratat e punësimit për stafin akademik si dhe atë joakademik. GVJ sugjeron që institucioni të orientohet ndaj politikave të burimeve njerëzore që të rrisin qëndrueshmërinë e stafit në këtë program studimi.

Qendrimi i GVJ mbi Komentet e institucionit: GVJ vlerëson pozitivisht incentivat e institucionit të përcjella në komente mbi draft-GVJ, për sigurimin e stafëve me nivele të larta kualifikimi, stafe të huaja, stafe nga ish studentet me nivel të lartë performance, etj. Keto incentiva mund të vlerësohen në vitet në vijim, për impaktin që do të kenë në qëndrueshmërinë e stafit. Pavaresisht sa më sipër, kriteri 3 synon të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të programit të studimit MSHAB, i cili rezulton me nivel qarkullueshmërie 35%, sic është përcjelle në draft GVJ, prandaj për sa më sipër, **komenti i institucionit nuk meret në konsiderat.**

Standardi IV.5

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.

GVJ në draft RVB është shprehur: GVJ konstaton se sipas tabelës 18, të ardhurat në dy vitet e fundit kanë qëndrueshmëri, por ato janë më të larta se 3-5 vite më parë. Rritje identifikohet në të ardhurat nga tarifat si dhe në të ardhurat nga projektet, të cilat deri 4 vite më parë referuar tabelës 18, kanë qenë 0. GVJ sugjeron që institucioni, të ndjek politika promovuese dhe më efektive për programin master i shkencave në AB me qëllim rritjen e numrit të studentëve në këtë program, me qëllim rritjen e të ardhurave nga tarifat e studentëve.

Qendrimi i GVJ mbi Komentet e institucionit: Kriteri i sipërcituar, fokusohet tek qëndrueshmëria financiare per zhvillimin e programit te studimit, MSHAB, ku te ardhurat nga studentet janë nder burimet kryesore. Keto te ardhura varen proporcionalisht nga numri i studenteve te regjistruar ne program. GVJ vlerëson punen qe behet ne vijimësi nga UE, por i qëndron mendimit qe këto politika duhet te intensifikohen per te qene me efektive lidhur me rritjen e numrit te studenteve.

Per sa me sipër, komenti i institucionit nuk meret në konsiderat.

Standardi VI.1

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

GVJ ne draft RVB eshte shprehur: UE nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra si pyetesoret e studenteve, shqyrtimet e ankimimeve, praktikave qe perdor bordi i provimeve etj, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Pavarësisht se raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, GVJ sugjeron që në këto raporte të identifikohen shembujt dhe praktikat e mira, për promovimin e kulturës së cilësisë, sikurse edhe diskutimin në rang departamenti të gjetjeve kryesore në terma të përgjithshëm si dhe ndarjen me stafin në mënyrë konfidenciale të rezultateve të vlerësimit të secilit pedagog.

Qendrimi i GVJ mbi Komentet e institucionit:

Lidhur me komentin qe institucioni ka paraqitur, institucioni do te marre parasysh ne vijimësi sugjerimin e dhene, prandaj per sa me sipër GVJ i qëndron sugjerimit te dhene ne draft RVJ lidhur me kete kriter. *Në RVJ final për MSHAB, nuk paraqiten ndryshime lidhur me këtë kriter.*

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Administrim Biznesi”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> | <p>Programet e studimit të ofruara nga Universiteti “EPOKA” ruajnë, konsolidojnë dhe nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe vlerat akademike e kulturore kombëtare. Baza ligjore mbi të cilën bazohen dhe janë ndërtuar rregulloret dhe Statuti i institucionit, si dhe bazohet gjithë veprimtaria e Universitetit Epoka është ligji i arsimit të lartë nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji (Statut, neni 2).</p> <p>Misioni i institucionit ku theksohet kontributi në përmirësimin e cilësinë e jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare (Statuti neni 3). Një nga qëllimet kryesore të institucionit është të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal.</p> <p>Universiteti “EPOKA” ka në përbërje 3 Fakultete:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, • Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe • Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. <p>Vizioni i institucionit është vënia e theksit në marrëdhënien ndërmjet njohurive, risive dhe shërbimit ndaj komunitetit. Institucioni synon të drejtojë studentët me anë të të mësuarit të aftësive të nevojshme dhe kërkimit shkencor, duke theksuar rolin e dijes në zgjidhjen e problemeve që përball komunitetit (EPOKA University Framework Strategy and Action Plan, vision).</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i></p> |

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> | <p>Programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. Misioni i Universitetit “EPOKA”, është në thelb të aktivitetit të programit të studimit. Misioni është të qënit një institucion mësimor-kërkimor inovativ, në shërbim të vlerave njerëzore thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar dhe të kontriboj pozitivisht në cilësinë e jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale (Statut, neni 3).</p> <p>Për arritjen e misionit institucioni realizon qëllimet kryesore të ofrojë studime të thelluara dhe të kryejë kërkime shkencore, të përgatisë specialistë të lartë nëpërmjet programeve universitare mësimore- shkencore.</p> <p>Një nga qëllimet kryesore të institucionit është integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor dhe kualifikimi i specialistëve të lartë në fushat e studimit që ofrohen nga institucioni, Qëllimi i tërheqjes së specialistëve më të mirë dhe inkurajimi i tyre në fushat përkatëse për të dhënë kontributin e tyre, do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe rajonit, si dhe në rritjen e standarteve të demokracisë e të mirëqënies së shoqërisë.</p> <p>Statuti i Universitetit EPOKA përmban fushat e studimit dhe fusha e veprimtarisë së programit të studimit që është administrimi i biznesit është në përputhje me një nga fushat ekonomike të veprimtarisë së institucionit që janë ekonomiksi, banking dhe financa dhe administrimi i biznesit.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p> | <p>Universiteti “EPOKA” ofron 35 programe studimi. Universiteti “EPOKA” ka në përbërje 3 Fakultete, të cilët me anë të aktivitetit të tyre mësimor shkencor realizojnë programet e studimit në fushat e drejtimit akademik të Institucionit.</p> <p>Programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi, ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative dhe ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Institucioni ka hartuar kornizën strategjike dhe planin e veprimit për 2017-2022.</p> |
| | <p>Masteri Shkencor pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, shkencore dhe praktike në fushën e studimit. Masteri Shkencor në Administrim Biznesi pajis studentët me njohuri në fushën e administrim biznesit.</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>Programi i studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Statutin e institucionit. Statuti përcakton se një nga qëllimet kryesore të institucionit që është të përgatisë specialistë të lartë më përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim në fushën e inxhinierisë kompjuterike, inxhinierisë elektronike, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, ekonomiksit, bankingut dhe financës, administrimit të biznesit, drejtësisë, shkencave politike e marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe shkencave të tjera sociale me formim të përgjithshëm nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar teorik, metodik dhe praktik. Institucioni në strategjinë e tij ka ndër të tjera, fokus vazhdimin e ofrimit të arsimit në fushat e biznesit, sipërmarrjet sociale dhe turizmin. Institucioni nëpërmjet veprimtarisë së saj dhe marrëveshjeve synon të ndikojë në zhvillimin e komunitetit përreth dhe të mundësoj internship për studentët në bizneset e komunitetit përreth institucionit.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p> | <p>Universiteti “EPOKA” ka në strategji të vazhdojë të bashkëpunojë me partnerët për të aplikuar në projektet kërkimore të financuar nga BE. Strategjia e Institucionit është të vazhdojë të rris financimet drejt fakulteteve për kërkime shkencore, me synim arritjen e ekselencës në kërkim shkencor, mësimdhënie, performancën e studentëve dhe në menaxhim.</p> <p>Qëllimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 është formimi cilësor i të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.</p> <p>Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë me anë të bashkëpunimit ndërkombëtar në institucionet e arsimit të lartë është një nga prioritetet e strategjisë. Programi i studimit me lëndët që përmban, ofrohet në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit. Institucioni ka si target tregun rajonal dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë, kryesisht me programet e studimit master dhe doktoraturë.</p> <p>Krijimi i kërkuesve shkencorë dhe profesionistëve në fushën e administrimit të biznesit, e realizuar nëpërmjet programit të studimit, duke synuar si integrimin e të rinjve në arsimin e lartë ashtu edhe përmirësimin dhe zhvillimin e ekonomisë së komunitetit</p> |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>përreth dhe të ekonomisë në përgjithësi, është në përputhje me interesat kombëtare të shprehura në strategjinë e zhvillimit të Arsimit të lartë. Një nga qëllimet e politikës së strategjisë kombëtare të zhvillimit është arsimi gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetin akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p>GVJ konstaton se programet e studimit të ofruara nga Universiteti "EPOKA" ruajnë, konsolidojnë dhe nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe vlerat akademike e kulturore kombëtare. Misioni i institucionit ku theksohet kontribuimi në përmirësimin e cilësinë e jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare. Institucioni ka hartuar kornizën strategjike dhe planin e veprimit për 2017-2022. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë me anë të bashkëpunimit ndërkombëtar në institucionet e arsimit të lartë është një nga prioritetet e strategjisë. Institucioni ka si target tregun rajonal dhe ndërkombëtar të arsimit të lartë, kryesisht me programet e studimit master dhe doktoraturë.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi I.2 | |
| Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | <p>Programi i studimit është licensuar me VKM nr.908, dt 26.08.2009, dhe me Urdhëresën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë nr.248, dt 06.05.2010, i është dhënë leja për zhvillimin e aktivitetit. Sipas RVB ky program studimi ka filluar të ofrohet gjatë vitit akademik 2011-2012, duke pasur tashme një experience mbi 10 vjeçare.</p> <p>Universiteti "EPOKA" është licensuar me VKM nr.281, dt.12.03.2008, me një eksperience rreth 15 vjeçare. Eksperienca ka</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>rëndësi të veçantë në fushën-akademike për të kuptuar që një program studimi ka pasur sukses dhe kërkesë tregu për të.</p> <p>Ky program studimi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i cili ka në përbërje 29 staf akademik PAE dhe 17 staf akademik PAK, nga të cilët 10 janë të kategorisë profesor dhe 16 personel janë me gradën shkencore Doktor. Në total janë 26 personel akademik me grada dhe tituj që përbëjnë 52% të stafit akademik gjithsej në përbërje të FEA, të cilët janë garanci për eksperiencë dhe ekspertizë në fushën ekonomike.</p> <p>Stafi akademik që zhvillon veprimtarinë e programit të studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi, është me tituj dhe grada shkencore.</p> <p>Kapacitetet infrastrukturore janë në dispozicion të programit të studimit. Kapacitetet infrastrukturore u verifikuan nga GJV gjatë vizitës dhe janë të pasqyruara në Tabelat Përmbledhëse të depozituara së bashku me dokumentacionet.</p> <p>Sikurse përmendet në Strategjinë e Universitetit, Universiteti “EPOKA” ka kampus të vendosur në zonë të gjelbër jashtë qytetit të Tiranës. Fasilitetet që ofrohen në kampus mundësojnë ofrim të shërbimit ndaj studentëve me cilësi të lartë.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese PM BUS.pdf</i> <i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i> <i>Annex 68. Infrastructure in service to study programs, logistics and other services towards the community.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Në nenin 37 të Rregullores së FEA cilësohet se programet e studimit që ofrohen nga Universiteti “EPOKA” janë të parashikuara në Statut. Në Statut përcaktohen fushat e studimit një prej të cilave është administrimi i biznesit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është administrimi i biznesit, duke qenë në përputhje me një nga fushat e studimit të Institucionit.</p> <p>Universiteti “EPOKA” ofron programe studimi në të 3 ciklet e studimit, Bsc, Master dhe PhD. Në fushën e Administrim Biznesit ofrohen edhe program studimi i ciklit të tretë duke përputhur fushën e kërkimit shkencor me fushën e studimit të programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi.</p> <p>Sipas RVB, Universiteti “EPOKA” është në proces kodifikimi të të gjitha programeve të studimit, në përputhje me Udhëzimin nr.31, dt. 15.11.2022 “Për procedurat në lidhje me kodifikimin e programeve</p> |




| | |
|---|--|
| | <p>të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Universiteti “EPOKA” që nga themelimi ka zbatuar kodifikimin e programeve dhe lëndëve.</p> <p><i>PM BUS RVB Shqip.pdf</i> <i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Fushat e studimit janë përcaktuar në Statutin e Universitetit “EPOKA” dhe Programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi ofrohet nga Departamenti Administrim Biznesi, FEA.</p> <p>Në Statut, neni 12 përcaktohet se Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofrohen si dhe për cilësinë e programeve të studimit.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p> | <p>Programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi është në përputhje me profilin e Universitetit “EPOKA”. MSH në Administrim Biznesit ofrohet nga Departamenti Administrim Biznesi, FEA. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies, punës kërkimore-shkencore, është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe siguron cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se Universiteti “EPOKA” ka një eksperiencë rreth 15 vjecare. Eksperienca ka rëndësi të veçantë në fushën -akademike për të kuptuar që një program studimi ka pasur sukses dhe kërkesë tregu për të.</i></p> <p><i>Universiteti “EPOKA” ofron programe studimi në të 3 ciklet e studimit, Bsc, Master dhe PhD. Kapacitetet infrastrukturore janë në</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>dispozicion të programit të studimit. Kapacitetet infrastrukturore u verifikuan nga GVJ gjatë vizitës. Fushat e studimit janë përcaktuar në Statutin e Universitetit "EPOKA" dhe Programi i studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi ofrohet nga Departamenti Administrim Biznesi, FEA. Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofrohen si dhe për cilësinë e programeve të studimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi I.3 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | <p>Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. Në Institucion veprimtaria realizohet me ndarje të detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Neni 10 i Statutit të Universitetit "EPOKA" është përcaktuar organigrama, e cila shpreh lidhjet dhe varësitë ndërmjet tyre, të cilat pasqyrojnë dhe ndarjen e detyrave.</p> <p>Përbërja strukturore dhe organizative e institucionit ndahet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> — Pjesa akademike, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese akademike të te gjitha niveleve. — Pjesa administrative, e cila përbëhet nga organet dhe autoritetet drejtuese administrative. <p>Në Universitetin "EPOKA" organet drejtuese dhe të tjera janë: Senati akademik, Rektorati, Dekanatet, Asambletë e personelit akademik të njësive kryesore, Këshilli i Etikës, Komisionet e përhershme, NJSBC, Bordi i Administrimit.</p> <p>Në Universitetin "EPOKA" autoritetet drejtuese dhe të tjera janë : Rektori, Dekani, Drejtuesi i Departamentit, Drejtori i qendrës kërkimore-shkencore, Administratori i Universitetit, etj.</p> <p>Statuti dhe Rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë kanë të përcaktuar ndarje të qarta të përgjegjësive. Rregullorja e FEA në nenin 3 përcakton se shtrin efektet e saj në të gjitha njësitë përbërëse, personelin akademik dhe ndihmes akademik, studentët dhe personelin administrativ.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Universiteti “EPOKA” përbëhet nga tre fakultetet të cilat kanë së paku nga tre njësi bazë (departamente / qendra kërkimore-shkencore).</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> | <p>Universiteti “EPOKA” për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p>Strategjia e Universitetit në bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit ka në fokus rritjen e cilësisë së mësimdhënies, ngritjen e imazhit të institucionit, shkëmbimi studentëve me anë të mobiliteteve dhe bashkëpunime shkencore.</p> <p>Universiteti “EPOKA” ka zhvilluar Strategji për ndërkombëtarizimin e institucionit, e cila është në përputhje me Strategjinë kombëtare për zhvillim.</p> <p>Është pjesë e Strategjisë së Universitetit dhe planit të veprimit që në fushën e mësimdhënies nëpërmjet departamenteve duhet të rritet përpjekja drejt ndërkombëtarizimit dhe partneritetit strategjik me universitete perëndimore, sektorin publik dhe sipërmarrjet e biznesit.</p> <p><i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i> <i>Annex 93. On the institutional and unit internationalization strategy.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e</p> | <p>Programi i studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi nuk përmban në kurrikul Praktikë Profesionale.</p> <p>Lëndët në syllabuse kanë të parashikuar zhvillimin e orëve studimore jashtë auditorit për të konkretizuar teorinë dhe kërkimin me praktikën dhe për këtë kompania ka lidhur marrëveshje me institucione të ndryshme publike dhe private, të cilat ndihmojnë studentët në zhvillimin e projekteve dhe rasteve studimore.</p> <p><i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i></p> |

| praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | | | | | | | | | |
|---|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | <p>Universiteti “EPOKA” dhe Departamenti i Administrim Biznesit hartojnë raporte periodike analitike në të cilat analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat duke përfshirë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Në fund të cdo viti akademik Departamenti përgatit një raport vjetor. Në dokumentat e depozituara nga institucioni GVJ konstaton se Raporti vjetor i Departamentit i përket vitit akademik 2019-2020, dhe nuk ka raporte të tjera të viteve të mëpasme. Universiteti EPOKA harton Raport vjetor në lidhje me objektivat, stafin, marrëveshjet, etj..</p> <p><i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i></p> | | | | | | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ konstaton se Statuti dhe Rregulloret e njësive kryesore dhe njësive bazë kanë të përcaktuar ndarje të qarta të përgjegjësiave. Strategjia e Universitetit në bashkëpunimet brenda dhe jashtë vendit ka në fokus rritjen e cilësisë së mësimdhënies, ngritjen e imazhit të institucionit, shkëmbimi studentëve me anë të mobiliteteve dhe bashkëpunime shkencore, duke synuar edhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</i> | | | | | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
|---|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| Standardi II.1 | |
|---|---|
| Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri”.</p> <p>Programi i studimit organizohet dhe ka kohëzgjatje prej 2 vitesh studimit me 120 ECTS në total. Lëndët janë të shprehura në kredite ECTS.</p> <p>Në planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një</p> | <p>Programi i studimit me anë të lëndëve të përfshira synon të japë njohuri, shprehje dhe kompetenca profesionale në fushën e administrimit të biznesit që është edhe qëllimi i këtij programi mësimor, si dhe njohuri të thelluara në financë.</p> <p>Në lëndët bazë të programit për të zhvilluar kompetenca të avancuara kërkimore studentët është lënda Metodatat e kërkimit në Biznes.</p> <p>Në lëndët Karakterizuese lëndët ofrojnë njohuri dhe kompetenca në fushën e administrimit të biznesit.</p> <p>Në lëndët ndërdisiplinore ka lëndë nga fusha të tjera studimi dhe nëse zgjidhen lëndë nga fusha të tjera studimi studenti do të kishte formim jo të plotë në administrim biznesi. Por, gjatë vizitës Grupit të VJ ju komunikua që këshilltari i studentit e orienton në zgjedhjen e lëndëve me zgjedhje në mënyrë që të jenë të duhurat për fitimin e kompetencave. Ndërkohë që nëse krahasojmë planin mësimor të Programit të studimit me kurrikulën, në kurrikulën ku paraqiten tipet e veprimtarisë lëndët karakterizuese janë vendosur me</p> |

| | |
|--|--|
| <p>fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>zgjedhje në program, (Analiza Strategjike, Ligji tatimor shqiptar, Menaxhimi i markës, etj.)</p> <p>Njohuritë e fituara kompletojnë të diplomuarin me aftësi vendimmarrëse të nevojshme në bizneset që ata do të punësohen dhe do të drejtojnë, duke qenë profesionist për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e studimit.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> | <p>Programi i studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Neni 42 i Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë, në rastin e Masterit Shkencor nëse studenti merr 120 kredite ECTS, ai merr Diplomen në Master Shkencor.</p> <p>Plani mësimor për programin e studimit i dhënë në tabelat e vëna në dispozicion nga institucioni në Tabelat përmbledhëse i paraqet lëndët të ndara sipas tipit të veprimtarisë.</p> <p>Si Lëndë bazë është vetëm një lëndë me 7.5 kredite ECTS që përbën 6.25% të krediteve.</p> <p>Në cdo semester plani mësimor ka nga 2 lëndë të detyrueshme, të cilat janë lëndë bazë ose karakterizuese (6 në total), duke pasur kështu 7.5 ECTS nga lënda bazë dhe 37.5 ECTS nga lëndët karakterizuese.</p> <p>Cdo semestër ka 2 lëndë me zgjedhje, 6 në total. Për të përzgjedhur 2 lëndët me zgjedhje në semestrin e parë studentët ka 10 mundësi nga të cilat 2 janë lëndë karakterizuese. Në semestrin e 2 për të zgjedhur 2 lëndë janë 7 mundësi nga të cilat 3 janë lëndë karakterizuese. Në vitin e 2 për të zgjedhur 2 lëndë janë 8 mundësi të cilat janë lëndë karakterizuese, duke bërë që të 4 lëndët të jenë karakterizuese dhe në total kreditet e lëndëve karakterizuese janë minimum 60 ECTS, që përbëne 50% të totalit të krediteve dhe plotësohet kriteri 50-55% i Lëndëve karakterizuese.</p> <p>Nga planet mësimore rezulton se totali i krediteve të veprimtarive A dhe B janë jo më pak se 60% në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> |




| | |
|---|--|
| | <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ ju komunikua se studentët orientohen në përzgjedhje, gjë që parashikohet në nenin 20 të Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Mikroteza (Tema e diplomës) ka 30 kredite ECTS. Plani mësimor nuk ka Praktikë Profesionale.</p> <p><i>GVJ sygjeron të përcaktohen më shumë lëndë të detyrueshme. Programi i studimit përfshin 12 lëndë nga të cilat 6 të detyrueshme, dhe stabiliteti në vijimësinë e kurrikulës së Masterit nga njëri vit në tjetrin është jo i sigurt.</i></p> <p><i>Tabela Ascal_MSC BF.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p> | <p>N/A</p> |




| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimit i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>RVB shprehet Universiteti “EPOKA” ndjek një politikë të përcaktuar për pranimin e studentëve në përputhje me të gjitha programet e studimit që ofrohen aktualisht si për student vendas dhe të huaj. Nenet 70-76 të Statutit përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve. Neni 71 prashikon edhe trajtimin e rasteve kur studenti për arsye sëmundje apo shkaqe të tjera kërkon leje.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p> | <p>Plani mësimor i programit të studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi është i hartuar nga lëndë të cilat përmbajnë njohuri të nevojshme dhe të përditësuara për kompletimin e njohurive në fushën e administrimit të biznesit. Plani mësimor në lëndët me zgjedhje ka edhe lëndë të fushës së finances, kontabilitetit dhe shkencave politike.</p> <p>Duke qenë se plani mësimor përmban 6 lëndë të detyrueshme dhe 6 me zgjedhje, ku tek lëndët me zgjedhje ka lëndë nga fushat e tjera, nëse studenti zgjedh lëndët jo menaxheriale programi i studimit nuk do të plotësonte së pari qëllimin e tij dhe së dyti ngjashmërinë me së paku 70% të programeve të ngjashme.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p> | <p>Universiteti “EPOKA” ka respektuar kodifikimet e programeve dhe lëndëve që në fillime të aktivitetit. Me shkresë të datës 02.12.2011 Ministria e Arsimit dhe Shkencës i ka dërguar Institucionit numrin e identifikimit të programeve të studimit. Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka numër identifikimi 000508.</p> <p>Sipas RVB, Universiteti “EPOKA” është në proces kodifikimi të të gjitha programeve të studimit, në përputhje me Udhëzimin nr.31, dt. 15.11.2022 “Për procedurat në lidhje me kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kodifikimi i propozuar nga Institucioni nuk është miratuar ende nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p><i>Shkresë Nr., datë 2011-12-02. Dergohen numra identifikimi</i></p> |




| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>RVB_MSC_BUS_Shqip.pdf</i> | | | |
| Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi nuk ofrohet si program i përbashkët me institucion tjetër të arsimit të lartë. Masteri i Shkencave në Administrim Biznesi ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit të FEA, Universiteti "EPOKA". <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> | | | |
| Konkluzione | <ul style="list-style-type: none"> <i>GVJ konstaton se programi i studimit Masteri Profesional në Administrim Biznesi ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015. Njohuritë e situara kompletojnë të diplomuarin me aftësi vendimmarrëse të nevojshme në bizneset që ata do të punësohen dhe do të drejtojnë, duke qenë profesionist për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e studimit. Programi i studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. GVJ sygjeron të përcaktohen më shumë lëndë të detyrueshme. Programi i studimit përfshin 12 lëndë nga të cilat 6 të detyrueshme, dhe stabiliteti në vijimësinë e kurrikulës së Masterit nga njëri vit në tjetrin është jo i sigurt. Gjë që do të konsolidojë edhe ngjashmërinë 70% me programet e ngjashme.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin. Ky program studimi është akredituar 2 herë. Akreditimin e parë e ka marrë në bazë të Urdhërësës nr,286, datë 06.06.2012, ndërsa akreditimin e dytë në datën 28.09.2018.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka në përbërje tre Departamente:

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financë-Bankës
- Departamenti i Administrim Biznesit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti 29 pedagogë PAE (në Tabelat përmbledhëse ka një lapsus në numrin e PAE, ku paraqiten 33 PAE) dhe 17 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Tabela 1

| Cilësia e stafit Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative (Tabelat përmbledhëse: Tabelat 1) | | | | | | |
|--|-----------|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Titulli/Grada | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 2 | - | 3 | - | 4 | - |
| Prof.Asoc. | 4 | - | 4 | 2 | 3 | 3 |
| Dr | 10 | 3 | 9 | 5 | 9 | 7 |
| Msc | 7 | 3 | 10 | 4 | 13 | 7 |
| Gjithsej | 23 | 6 | 26 | 11 | 29 | 17 |

Departamenti i Administrim Biznesit si njësi përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe

akreditimin. Në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga 14 pedagogë PAE dhe 3 Personel Akademik me Kontratë, si në tabelën vijuese:

Tabela 2

| Cilësia e stafit të Departamentit të Administrim Biznesit përgjegjës për programin e studimit MSC në Administrim Biznesi (Tabelat përmbledhëse: Tabelat 2) | | | | | | |
|---|-----------|----------|-----------|----------|-----------|----------|
| Titulli/Grada | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 1 | - | 1 | - | 3 | - |
| Prof.Asoc. | 2 | - | 4 | - | 3 | 2 |
| Dr | 4 | - | 2 | - | 3 | 1 |
| Msc | 1 | 2 | 3 | 3 | 5 | - |
| Gjithsej | 8 | 2 | 10 | 3 | 14 | 3 |

Për realizimin e procesit mësimor në programin e studimit MSC në Administrim biznes, ndër vite janë të angazhuar kryesisht Personel Akademik Efektiv (PAE), nga tabelat e Programit të studimit është përpiluar tabela e stafit si vijon:

Tabela 3

| Stafi akademik për programin e studimit MSC në Administrim Biznesi (Tabelat përmbledhëse: Tabelat 6) | | | | | | |
|---|-----------|----------|-----------|----------|-----------|----------|
| Titulli/Grada | 2020-2021 | | 2021-2022 | | 2022-2023 | |
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof.Dr | 1 | 1 | 2 | - | 3 | - |
| Prof.Asoc. | 3 | 1 | 4 | - | 2 | - |
| Dr | 10 | 1 | 6 | 3 | 6 | 3 |
| Gjithsej | 14 | 3 | 12 | 3 | 11 | 3 |

Urdhër Nr.286, datë 2012-07-06

Vendim Nr.60, datë 2018-09-28

RVB_MSC_BUS_Shqip.pdf

Summary Tables MSC BUS.pdf

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e

Nga Tabelat përmbledhëse që janë vënë në dispozicion nga Institucioni nuk ka informacion në lidhje me angazhim të personelit ndihmës akademik. Në Statut, neni 75 saktëson se Personeli ndihmës akademik ka karakter mësimor dhe ndihmor në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Gjatë vizitës GVJ u informua

| | |
|---|---|
| <p>përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p> | <p>se stafi akademik zhvillonte detyra administrative, dhe nxiteshin edhe studentët të merrnin pjesë në veprimtaritë administrative.</p> <p>Personeli ndihmës akademik është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarisë së kësaj të fundit. Në këtë kategori bëjnë pjesë asistentët mësimorë dhe kërkimorë, laborantët, teknikët, si dhe çdo personel tjetër.</p> <p>Në RVB theksohet se stafi akademik inkurajohet të marrë pjesë dhe të angazhohet në trajnime duke ndjekur synimet kryesore të Kuadrit Strategjik 2018-2022. Në këtë drejtim janë zyrat administrative që investojnë në hapjen dhe propovimin e mundësive të trajtimit.</p> <p><i>RVB_MSC BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>Në Rregulloren e programeve të studimit të ciklit të dytë, neni 7, specifikohet se çdo department përgjegjës, përcakton një Komitet Shkencor për çdo Program studimi të ciklit të dytë, i cili konsiston në jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik që kanë së paku gradën shkencore Doktor. Komiteti Shkencor është përgjegjës për organizimin e programit të studimit të ciklit të dytë respektiv, dhe zgjedh një nga anëtarët Kordinator të Programit.</p> <p>RVB shprehet se drejtuesi i Departamentit të Administrim Biznesit në cilësinë e autoritetit drejtues të Departamentit është edhe kordinator akademik i programit të studimit Masteri Shkencor në Administrim Biznesi.</p> <p>Për ecurinë sa më të mirë dhe zhvillimin e programit të studimit Departamenti cakton një këshilltar akademik për çdo grup studentësh, i cili është përgjegjës për miratimin e lëndëve të ndjekura nga studentët çdo semestër si dhe për tu ofruara atyre udhëzime akademike deri në diplomim.</p> <p><i>RVB_MSC BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se Departamenti i Administrim Biznesit si njësia përgjegjëse për programin e studimit, për realizimin e procesit mësimor në programin e studimit MSC në Administrim biznes, ndër vite ka angazhuar kryesisht Personel Akademik Efektiv (PAE) me grada dhe tituj akademik. Personeli ndihmës akademik ka karakter mësimorë, si asistentët mësimorë dhe kërkimorë, laborantët, teknikët, si dhe çdo personel tjetër dhe është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>Çdo department përgjegjës, përcakton një Komitet Shkencor për çdo Program studimi të ciklit të dytë. Drejtuesi i Departamentit të Administrim Biznesit në cilësinë e autoritetit drejtues të Departamentit është edhe</i></p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>kordinator akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master Shkencor në Administrim biznes është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Universiteti “EPOKA”. Departamenti i Administrim Biznesit është njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master Shkencor në Administrim biznes. Si njësia kryesore ashtu edhe njësia bazë disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Dokumentacioni i depozituar nga institucioni reflekton një informacion të plotë dhe të nevojshëm për kuptuar organizimin dhe strukturën e programit të studimit.</p> <p>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Statutin e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, Rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimit, Kurrikulën e Programit të studimeve, Planin mësimor, etj.</p> <p><i>RVB_MSC BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p> | <p>Programi i studimit përmban planin mësimor për zhvillimin e Masterit Shkencor në Administrim Biznesi, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p> <p>Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, neni 37, pika b1. përcakton se programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, të cilat realiohen me 120 kredite ECTS me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, dhe në përfundim lëshohet diplomë “Master i shkencave”. Diploma</p> |




| | |
|--|--|
| | <p>përmban të gjithë elementët e parashikuar nga dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>Programi mësimor ka edhe lëndë me zgjedhje të hapura nga departamenti përgjegjës ose departamente të tjera. Rregullorja e Fakultetit në nenin 51 shprehet për mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të mësimdhënies, në lidhje me lëndët me parakusht ose jo, me detyrim apo me zgjedhje.</p> <p>Plani mësimor i Programit të studimit përmban 12 disiplina dhe Mikrotezën. Nga 12 lëndët 6 prej tyre janë të detyrueshme dhe 6 janë me zgjedhje. Plani mësimor përmban informacionin në lidhje me orët që zhvillohen brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo lëndë. Çdo kredit vlerësohet 25 orë, ku realizohen 1500 orë në vit, me një në total prej 3000 orësh në këtë program studimi.</p> <p>Në planin mësimor përcaktohen kreditet ECTS për çdo lëndë, të cilat janë të unifikuara me 7.5 ECTS secila. 7.5 ECTS *12= 90 ECTS, Mikroteza ka 30 ECTS.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Në Statutin e Universitetit “EPOKA”, neni 91, përcakton kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Kriteret kryesore të pranimit përcaktojnë se aplikantët duhet të kenë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe të plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit të Universitetit “EPOKA”. Kriteret e pranimit jepen më të detajuara në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, neni 69 dhe në nenin 13 të Rregullores së programeve të ciklit të dytë të studimit. Programi i studimit ofrohet në gjuhën Angleze dhe një nga kriteret specifike është njohja e gjuhës Angleze e vërtetuar me një certifikatë ndërkombëtare të mbrojtjes së gjuhës, të përcaktuara në rregullore, në nivelin B2.</p> <p>Neni 15 i Rregullores së programeve të ciklit të dytë të studimit shprehet për pranimin e studentëve me status të veçantë, ndërsa neni 19 shprehet për pranimin e studentëve të huaj.</p> <p>Në Statutin e Universitetin “EPOKA”, neni 92, shprehet se Universiteti ofron mundësi për transferime të studimeve të studentëve nëpërmjet programeve të ciklit të dytë, brenda programeve të Universitetit “EPOKA” apo nga dhe/ose drejt institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Kriteret kryesore për</p> |




| | |
|--|--|
| | <p>njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë: ngjashmëria e programit të studimit; koha e kryerjes së studimeve; të jetë i përfshirë në Sistemin e Bolonjës.</p> <p>Neni 24 i Rregullores së programeve të ciklit të dytë të studimit specifikon kriteret e transferimeve. Aplikimi vlerësohet nga Komiteti Shkencor i programit përkatës të studimit ku studenti dëshiron të transferohet dhe miratohet nga Dekanati i Fakultetit.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Programi mësimor propozohet nga departamenti përkatës, miratohet nga Dekanati dhe paraqitet për miratim përfundimtar në Senatën Akademik. Në nenin 79 të Statutit të Universitetit “EPOKA” jepen Format dhe programet e studimit që ofron Institucioni.</p> <p>Programi i studimit Masteri i Shkencave Administrim Biznesi përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset). Programi i studimit jep informacion në lidhje me kreditet dhe orët që zhvillohen në leksione dhe seminare, brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo modul. Çdo lëndë ka 7.5 ECTS dhe 48 orë në auditor. Ndërsa puna individuale në çdo lëndë është e përcaktuar 139.5 orë, me përjashtim të Mikrotezës.</p> <p>Syllabuset e lëndëve japin informacionin në lidhje me lëndën, nëse është me zgjedhje apo detyrim, semestrin që zhvillohet, kreditet, formën e mësimdhënies, formën e kontrollit të dijes, etj.</p> <p>Në Tabelat përmbledhëse jepet me anë të një modeli struktura e syllabusit. Në nenin 51 i Rregullores së Fakultetit shpjegohet programi mësimor. Lëndët me zgjedhje në programin mësimor përbëhen nga lëndët me zgjedhje semestrare të ofruara nga departamenti që është përgjegjës për programin e studimit dhe nga lëndët me zgjedhje të ofruara nga departamentet e tjera.</p> <p>Programi mësimor i modulit (syllabusit) jep informacionin për emërtimin e lëndës, tipin e veprimtarisë, orët e leksioneve dhe seminarëve, lektorin/lektorët që do të zhvillojnë lëndën, masterin përkatës ku zhvillohet, semestrin kur zhvillohet, peshën e ECTS, gjuhën, objektivat e modulit, temat që do të zhvillohen, etj.</p> <p>Format e mësimdhënies në programin e studimit Master i shkencave në Administrim Biznesi janë leksionet (ligjëratat) të cilat zhvillohen</p> |




| | |
|--|--|
| | <p>3 orë në javë ku zhvillohen edhe ushtrimet, rastet e studimeve, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj.</p> <p>Në syllabuse jepet informacion për përqindjen që zënë në vlerësim detyrat e shtëpisë, projektet, detyra e kontrollit, prezantimet e detyrave dhe orët e laboratorit, si dhe mënyrën e vlerësimit. Pësha që zënë elementët e ndryshëm në vlerësim varion nga lëndë në lëndë në varësi të qëllimit dhe natyrës së lëndës. Ka lëndë që vlerësimin final e kanë me punim (paper) dhe ka lëndë që vlerësimin final e ka me provim, ku mund të zhvillohet një provim final ose një provim i ndërmjetëm dhe një final.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit përcaktohet mënyra e vlerësimit, sistemi i provimeve dhe kalueshmëria (Kreu III, neni 55).</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p> | <p>Në dokumentin e Planit Strategjik të Departamentit të Biznes Administration janë paraqitur sfidat për të ardhmen për departamentit. Ndryshimi i teknologjisë, ndryshimi i mjedisit ekonomik nxit departamentin të ketë si qëllim të tërheq staf akademik të kualifikuar dhe të ofrojë infrastrukturën e nevojshme. Për shkak të tregut dhe bizneseve dinamike departamenti duhet të jetë vigjilent në vëzhgimin e qasjes dinamike të sistemit kompleks të bizneseve në mënyrë që të përshtas kurrikulën me ndryshimet e pritshme të tregut.</p> <p>Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka ndryshuar me vendim të Senatit Akademik të Universitetit Epoka nr 06 datë 29.07.2020, ndryshimet kanë konsistuar në ndryshim të krediteve të lëndëve.</p> <p>Në 27.03.2018 Universiteti “EPOKA” ka miratuar Politikën e përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. Rishikimi i programit mësimor është përgjegjësi e Departamentit përgjegjës dhe komisionit të zhvillimit të kurrikulës. Përmirësimi cilësor i programeve të studimit është thelbësor për misionin e Universitetit.</p> <p>Sipas Manualit të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit “EPOKA”, në fund të çdo viti realizohet rishikimi i programit të studimit.</p> <p><i>Annex 3. Decisions of Academic Senate related to the Study Program Curricula.pdf</i></p> |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>Annex 7. BUS Department Strategic Plan 2017-2022.pdf</i> <i>Annex 21. Quality Assurance Handbook.pdf</i> <i>Annex 54. Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon të gjithë informacionin për zhvillimin e programit të studimit si: Statutin e Universitetit, Rregulloren, Rregulloren e programeve të ciklit të dytë të studimit, Kurrikulën e Programit të studimeve, Planin mësimor, etj.</i></p> <p><i>Master i Shkencave në Administrim Biznesi përmban 120 kredite me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Në planin mësimor përcaktohen kreditet ECTS për çdo lëndë të cilat janë të unifikuara me 7.5 ECTS secila, dhe për mikrotezën e cila ka 30 ECTS. Në Statutin e Universitetin "EPOKA", në Rregulloren e Fakultetit, në Rregulloren e programeve të ciklit të dytë të studimit përcaktohen kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve.</i></p> <p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset). Programi i studimit jep informacion në lidhje me kreditet dhe orët që zhvillohen në leksione dhe seminare, brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo modul.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|---|
| Standardi II.4 | |
| Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është i ndërtuar me lëndët më bashkëkohore të drejtimit të administrimit të biznesit për të siguruar përgatitjen e profesionistëve të nevojshëm për drejtimin e bizneseve. Rendësia e programeve të studimit është e madhe kur konsiderojmë impaktin që do të kenë bizneset në ekonomi.</p> <p>Emërtimi i lëndëve është në harmoni me përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve. Përmbajtja e lëndëve ofron njohuri të avancuara në</p> |




| | |
|---|---|
| | <p>drejtimin që synon të krijojë secila lëndë për arritjen e kompetencave të synuara të studentëve.</p> <p>Në këtë program studimi mundësohen njohuri të avancuara edhe në drejtime të tjera të shkencës së ekonomisë dhe më gjerë duke mundësuar njohuri të thelluara dhe kompetenca ndërdisiplinore për të arritur në vendimmarrje administrative eficiente.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p> | <p>Institucioni ka të publikuara fushat e studimit dhe një prej të cilave është administrimi i biznesit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është administrimi i biznesit, duke qenë jo vetëm në përputhje me një nga fushat e studimit të Institucionit por është edhe një nga fushat e studimit bashkëkohore për rëndësisë që ka administrimi në ekonominë e tregut. Lëndët ofrojnë njohuri për mënyrën e drejtimit të biznesit të vogël, i cili është dominant në ekonominë shqiptare.</p> <p>Lëndët mundësojnë kompetenca edhe për drejtim në bizneset ndërkombëtare duke ndihmuar në zhvillimin e profesionistëve në kushtet e globalizimit. Si lëndët ashtu edhe shpërndarja mundëson arritjen e rezultateve të pritshme prej programit të studimit.</p> <p><i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> | <p>Programi i studimit është ndërtuar që të zhvillohet në 2 vite akademike, me 4 semestra.</p> <p>Sikurse është përmendur më lart çdo lëndë, me përjashtim të Mikro tezës ka 7.5 ECTS dhe 48 orë në auditor. Ndërsa puna individuale në çdo lëndë është e përcaktuar 139.5 orë, me përjashtim të Mikrotezës, duke pasur një tota realizohen 1500 orë.</p> <p>Format kryesore e mësimdhënies në programin e studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi janë leksionet (ligjëratat) të cilat zhvillohen 3 orë në javë. Gjatë orëve të mësimi zhvillohen edhe ushtrime nëse lënda parashikon të tilla në program, rastet e studimeve, të cilat japin njohuri dhe kompetenca praktike, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Megjithatë informacioni i vënë në dispozicion nuk na mundëson llogaritjen e raportit teori praktikë.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i></p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Lëndët janë të ndara sipas veprimtarive formuese, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p>Lëndët që janë në përbërje të programit të studimit janë të rëndësishme, dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve si dhe mobilitetet.</p> <p>Lëndët që janë pjesë e programit mundësojnë kompletim të kompetencave në drejtimin e një biznesi duke thelluar njohuritë dhe mundësuar punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> | <p>Universiteti “EPOKA”, ofron programe në të tre ciklet e studimeve dhe qëllimi është zhvillimi dhe përgatitja e specialistëve në fushat e përcaktuara. Institucioni ka miratuar Politikën e përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. Rishikimi i programit mësimor është përgjegjësi e Departamentit përgjegjës dhe komisionit të zhvillimit të kurrikulës. Përmirësimi cilësor i programeve të studimit është thelbësor për ecurinë e Universitetit si IAL që ofron kurrrikula të përditësuar, të nevojshme për përgatitje të ekspertëve të fushës në një ekonomi dhe shoqëri me ndryshime dinamike.</p> <p>Sipas Manualit së Sigurimit të Cilësisë të Universitetit “EPOKA”, në fund të çdo viti realizohet rishikimi i programit të studimit.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 54. Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, lëndët dhe ndërtimi i tyre, struktura e mësimdhënies dhe e kontrollit të njohurive garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>Në program janë disa lëndë që ofrojnë kompetenca të nevojshme për një student në një Master shkencor si Skkrim Akademik që është lëndë e detyrueshme në semestër të parë. Kjo lëndë do të mundësoj</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>detyra, projekte dhe mikrotezën, të hartuara me rregullat e nevojshme të shkrimit akademik. Lëndët si Sipërmarrja dhe menaxhimi i biznesit të vogël, menaxhimi Strategjik, Biznesi ndërkombëtar, etj., japin njohuri për të kompletuar dhe thelluar njohuritë në menaxhimin e bizneseve duke u bazuar në trendet më të fundit të literaturave të përditësuara në këtë fushë.</p> <p>Programi ofron edhe njohuri ndërdisiplinore nëpërmjet lëndëve si Analiza financiare, Menaxhimi i portofolit dhe analiza financiare, Politika botërore, etj.</p> <p><i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve për studime të nivelit të tretë Phd. Lëndët e ofruara në këtë program janë të rëndësishme dhe mundësojnë krijimin e kompetencave dhe të punësimit të studentëve në fushën e administrimit të biznesit.</p> <p>Në një ekonomi dinamike kombëtare dhe ndërkombëtare programi studimit në MSC në Administrim Biznesi jep njohuri bashkëkohore për të drejtuar në një treg konkurrencial.</p> <p>Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve janë lëndë që formojnë një drejtues duke thelluar njohuritë e përfituara në bachelor dhe mundëson punësim të studentëve në fushën përkatëse.</p> <p><i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se lëndët ofrojnë njohuri për mënyrën e drejtimit të biznesit të vogël, i cili është dominant në ekonominë shqiptare. Lëndët mundësojnë kompetenca edhe për drejtim në bizneset ndërkombëtare duke ndihmuar në zhvillimin e profesionistëve në kushtet e globalizimit.</i></p> <p><i>Përmirësimi cilësor i programeve të studimit është thelbësor për ecurinë e Universitetit si IAL që ofron kurrikula të përditësuara, të nevojshme për përgatitje të ekspertëve të fushës në një ekonomi dhe shoqëri me ndryshime dinamike.</i></p> <p><i>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, lëndët dhe ndërtimi i tyre, struktura e mësimdhënies dhe e kontrollit të njohurive garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |

| | | | | |
|--|--|--|--|---|
| | | | | X |
|--|--|--|--|---|

| Standardi II.5 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p> | <p>Universiteti “EPOKA” e ka pjesë të politikës së zhvillimit përditësimin e përmbajtjes së programit të studimit me synim përshtatjen me tregun e punës.</p> <p>Në dokumentin e Përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit, përcaktohet se për përmirësimin e programit të studimit merret parasysh feedback nga Alumni, opinion i studentëve aktual dhe nevojat e tregut të punës.</p> <p>Nevojat e tregut të punës identifikohen nga konsultimet me partnerët e institucionit, dhe punëdhënësit e studentëve të punësuar. Institucioni kryen një anketë për studentët Alumni ku përveç informacioneve në lidhje me punëzënien, studentët Alumni komentojnë për përmirësimin e programit. Institucioni organizon pyetësor për punëdhënësit e studentëve të diplomuar ku tërheq mendimet tyre në lidhje me përgatitjen profesionale të studentëve.</p> <p><i>Annex 49. Company Satisfaction Survey 2018 - 2019.pdf</i> <i>Annex 54. Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf</i> <i>Annex 73. Student Satisfaction Survey.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> | <p>Institucioni tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin me anë të një pyetësori anonim, ku studentët shprehin opinionin e tyre.</p> <p>Në Statut është e përcaktuar që studentët janë të përfshirë në disa organe të institucionit si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, dhe në këto struktura tërhiqet mendimi i drejtpërdrejtë i tyre.</p> <p>Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar, prej të cilëve merr informacion në lidhje me punësimin e tyre, kërkesat e tregut të punës duke mundësuar edhe të kuptuarit e nevojës për ndryshim të programit.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 73. Student Satisfaction Survey.pdf</i></p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p> | <p>Drejtuësi i Departamentit të Administrim Biznesi drejton dhe kontrollon punën mësimore, kërkon rishikime dhe përmirësime të programit të studimit dhe të kurrikulave duke ju përshtatur ndryshimeve dhe zhvillimeve më të fundit dhe të vazhdueshme të ekonomisë dhe fushave të ndryshme (Statuti, neni 54).</p> <p>Drejtuësi i departamentit i propozon ndryshimin drejtuesit të njësisë kryesore dhe është ky i fundit që merr vendimet për ndryshime në planin mësimor, ndryshime që i propozohen më tej Senatit Akademik (Statut, neni 50).</p> <p>Për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit angazhohen drejtuesit, stafi akademik, punëdhënësit dhe studentët sikurse u përmend në kriterin e mësipërm. Po në këtë drejtim merren mendimet e studentëve aktual dhe të diplomuar nëpërmjet anketave dhe diskutimeve.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se nevojat e tregut të punës identifikohen nga konsultimet me partnerët e institucionit, dhe punëdhënësit e studentëve të punësuar.</i></p> <p><i>Institucioni kryen anketë me studentët Alumni ku përveç informacioneve në lidhje me punëzënieën, studentët Alumni komentojnë për përmirësimin e programit. Institucioni tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin me anë të një pyetësori anonim, ku studentët shprehin opinionin e tyre. Për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit angazhohen drejtuesit, stafi akademik, punëdhënësit dhe studentët sikurse u përmend në kriterin e mësipërm.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| <p>Standardi II.6</p> | |
|---|---|
| <p>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në</p> | <p>Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit. Lëndët që janë në përbërje të programit të studimit mundësojnë krijimin e profesionistëve në drejtimin e bizensit dhe mundësojnë kërkimin shkencor në Masterin Shkencor</p> |




| | |
|---|---|
| <p>përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p> | <p>në Administrim Biznesi. Në syllabuset e lëndëve përshkruhen objektivat kryesore dhe prioritetet e studimit.</p> <p>Objektivat e lëndëve në përbërje të programit të studimit janë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e institucionit si pregatitja e specialistëve të lartë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim edhe në fushën e administrim biznesit (Statuti, neni 3). Të ofrojë studime të thelluara akademike në fushën e administrim biznesit, të kryejë kualifikime për specialistë të lartë në fushën e administrimit të biznesit, etj., janë disa objektiva të tjera të institucionit që programi i studimit është në përputhje me to.</p> <p>Në mënyrë që programi i studimit të ciklit të dytë të zhvillohet në përputhje me objektivat e përcaktuara, departamenti përgjegjës i cili është edhe kordinatori i programit cakton një komitet shkencor përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p><i>Annex 92. Course Description.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> | <p>Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit. Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofron dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë në programet e ofruara. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore (Statuti, neni 12).</p> <p>Liria akademike garantohej nëpërmjet të drejtës (Statuti, neni 5):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, si dhe veprimtaritë krijuese. • Për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor dhe për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik. <p>Njësia kryesore Fakulteti ofron programe studimi të cikleve të ndryshme. Fakulteti bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (Statuti, neni 11)</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p> | <p>Studentët janë të përfshirë në disa organe kryesore dhe vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, dhe në këto struktura tërhiqet mendimi i drejtpërdrejtë i tyre.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GJVJ konstatoi një qasje motivuese ndaj studentëve nëpërmjet angazhimeve të tyre me detyra administrative si dhe me pjesëmarrje në publikime shkencore. Studentët janë pjesë</p> |




| | |
|--|---|
| | <p>integrale e të gjithë proceseve. Për secilin student Komiteti shkencor i programit të studimit cakton një këshilltar i cili e mbështet dhe orienton përgjatë studimeve.</p> <p>Institucioni ka lidhur marrëveshje me partnerë të ndryshëm, marrëveshje që studentët i shfrytëzojnë për zhvillimin e detyrave të kursit, projekteve, mikrotezave si dhe për mundësi punësimi.</p> <p>Në Kornizën e Strategjisë së Universitetit është shprehur se Institucioni ofron mundësitë për rritje të njohurive dhe aktiviteteve jashtekurrikulare dhe internshipeve.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i> <i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p> | <p>Universiteti “EPOKA” e ka prioritet zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndër objektivat e kërkimit dhe zhvillimit është sigurimi i mundësive për të përfshirë stafin në një rang të gjerë të aktiviteteve kërkimore. Këto mundësi përfshijnë mbështetje financiare dhe infrastrukturore. Aktivitetet kërkimore do të përfshijnë organizatat kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare duke pasur edhe fokus ndërdisiplinor.</p> <p>Në këtë drejtim departamentet lehtësojnë mobilitetet ndërkombëtare të kërkuesve, pjesëmarrjen në projekte europiane dhe programe të tjera ndërkombëtare.</p> <p>Sipas dokumentit të Kornizës së Strategjisë së Universitetit, Institucioni ka tre qendra kërkimore multi-disiplinare: Qendra e Studimeve Europiane të Universitetit EPOKA, Qendra e Kërkimit dhe Dizajnimit në Shkencat e Aplikuara dhe Qendra Yunus për Qëndrueshmërinë e organizatave sociale.</p> <p>Në fushën financiare objektivat e institucionit janë: të siguroj financim të përshtatshëm për aktivitetet e mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe të rrisë financimin e jashtëm prej projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe prej ofrimit të shërbimeve.</p> <p>Gjatë vizitës stafi na komunikoi se zbatohet sistem pikëzimi për mbështetje financiare të stafit, ku sa më lart e rankuar revista shkencore, aq më e lartë është mbështetja financiare, e shprehur në Direktiven për promovim të publikimeve shkencore. Stafi është i motivuar dhe në Annex 60 gjendet lista me publikime të 4 viteve të fundit.</p> <p><i>Annex 30. Directive On the Promotion of Scientific Publications.pdf</i> <i>Annex 60. List of Publications 2018-2022.pdf</i></p> |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se objektivat e lëndëve në përbërje të programit të studimit janë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e institucionit si përgatitja e specialistëve të lartë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim edhe në fushën e administrimit biznesit</i></p> <p><i>Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofron dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë në programet e ofruara. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore – shkencore.</i></p> <p><i>Institucioni zbaton sistem pikëzimi për mbështetje financiare të stafit, ku sa më lart e rankuar revista shkencore, aq më e lartë është mbështetja financiare, e shprehur në Direktiven për promovim të publikimeve shkencore.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi II.7 | |
| Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | <p>Aktivitetet kërkimore kordinohen nga Zyra e Projekteve dhe Kërkimit në bashkëpunim me Rektoren, Qendrën Kërkimore dhe Fakultetet. Aktivitetet e kërkimit shkencor kordinohen nga Qendra Kërkimore.</p> <p>Zyra e Projekteve dhe Kërkimit organizon organizon projektet e brendshme në të gjitha fazat që nga thirrja deri në implementim (Rregullore e Kërkimit Shkencor, neni 10)</p> <p>Qendra kërkimore shkencore është e organizuar pranë fakulteteve. Qendra kërkimore shkencore angazhohet në hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e projekteve të ndryshme kërkimore – shkencore dhe ndërmer kërkime shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit (Statuti, neni 13).</p> <p>Aktivitetet kërkimore rishikohen nga Qendra Kërkimore dhe menaxhohen nga Drejtorët e Qendrave Kërkimore respektive.</p> <p>RVB shprehet se në shtator 2022, Universiteti EPOKA nënshkroi një marrëveshje anëtarësimi me Crowdhelix, një platformë e Hapur Inovacioni dhe Rrjetëzimi, që krijon lidhje midis rrjeteve</p> |

| | |
|--|---|
| | <p>ndërkombëtare të universiteteve anëtare dhe institucioneve kërkimore, në mënyrë që të realizohen projekte bashkëpunuese.</p> <p><i>RVB_MSC BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 29. Regulation On Scientific Research.pdf</i> <i>Annex 30. Directive On the Promotion of Scientific Publications.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p> | <p>Universiteti EPOKA nxit personelin akademik që të aplikojnë në projekte dhe studime të ndryshme. Institucioni ofron përdorimin e infrastruktures për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe nxit personelin akademik dhe studentët për pjesëmarrje. Universiteti EPOKA nxit stafin me anë të stimujve financiarë dhe bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve që ka realizuar dhe i ka si objektiv të rrisë numrin e tyre.</p> <p>Në Tabelat përmbledhëse, tabela 19, jep të dhënat për aktivitete të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit, në vitet e fundit. Numri i botimeve të realizuara nga stafi akademik efektiv i departamentit janë 79. Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë Departamenti/Fakulteti janë 4 projekte të fituara nga jashtë dhe 1 projekt tashmë i zbatuar. Departamenti/ Fakulteti dhe IAL për programin kanë zhvilluar 7 aktivitete shkencore dhe numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore janë 10.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p> | <p>Në Rregulloren e kërkimit shkencor është e shprehur se kërkimi shkencor është një nga drejtimet kryesore të Universitetit. Stafi vlerësohet për publikimet shkencore.</p> <p>RVB shprehet se Departamenti është i angazhuar në organizimin e Konferencave Shkencore Ndërkombëtare dhe duke kontribuar dhe duke qenë partner në organizata të ndryshme konferencash shkencore të institucioneve të tjera partnere.</p> <p>Stafi dhe studentët janë motitvuar dhe angazhuar duke bashkëpunuar dhe kontribuar në prezantim dhe publikim të studimeve shkencore.</p> <p>Disa prej tyre janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ EPOKA/ GEDC/IFEES 2023 ▪ Konferenca e 7-të Ndërkombëtare për Studime Europiane-ICES 2020 ▪ Konferenca e Studentëve për Ekonomi, Financa, Biznes dhe Shkenca Sociale, SCE-2018 – SCE 2018. |




| | |
|---|--|
| | <p><i>RVB_MSC BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 29. Regulation On Scientific Research.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi me anë të lëndëve në përbërje të tij, mundëson formimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencor në administrim biznesi, të rëndësishëm për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar.</p> <p>Ky program studimi me anë të disiplinave që përfshin, me anë të metodologjisë së ndjekur, motivimit të stafit akademik dhe studentëve në konferenca dhe projekte përgatit profesionistë për tregun e punës.</p> <p>Gama e lëndëve i jep mundësi studentit që të fitojë njohuri të nevojshme mbi Lidërshtipin, Sipërmarrjen dhe menaxhimin e biznesit të vogël, Menaxhimi strategjik, Biznesi ndërkombëtar, Analiza e pasqyrave financiare për stafin menaxherial, etj., duke formuar profesionistë si në bizneset prodhuese, bizneset tregtare, në sektorin e shërbimit dhe atë financiar.</p> <p>Në Tabelat përmbledhëse, tabela 23 jep numrin e të diplomuarve të punësuar në përputhje me diplomën ku rezultojn se rreth 80% e të diplomuarve punojnë në fushën e studimit pas diplomimit.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p> | <p>N/A</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional</i></p> | <p>N/A</p> |




| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <i>Qualifications Directive, 2005/36/EU).</i> | | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ konstaton se qëndra kërkimore shkencore është e organizuar pranë fakulteteve. Qëndra kërkimore shkencore angazhohet në hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e projekteve të ndryshme kërkimore – shkencore dhe ndërmerr kërkime shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në Rregulloren e kërkimit shkencor është e shprehur se kërkimi shkencor është një nga drejtimet kryesore të Universitetit. Stafit dhe studentët janë motivuar dhe angazhuar duke bashkëpunuar dhe kontribuar në prezantim dhe publikim të studimeve shkencore. Ky program studimi me anë të disiplinave që përfshin, me anë të metodologjisë së ndjekur, motivimit të stafit akademik dhe studentëve në konferenca dhe projekte përgatit profesionistë për tregun e punës. Gama e lëndëve i jep mundësi studentit që të fitojë njohuri të nevojshme duke formuar profesionistë si në bizneset prodhuese, bizneset tregtare, në sektorin e shërbimit dhe atë financiar.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1 | | | | | | | | | |
|--|--|-----------------------|------------------------|----------|-----|-------------------------|----|----------|-----|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. | | | | | | | | | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, lëndët, struktura e mësimdhënies dhe e kontrollit të njohurive, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive mundësojnë përfitim njohurive të synuara.</p> <p>Lëndët e Programit të studimit MSHAB zhvillohen nëpërmjet formave tradicionale të mësimdhënies, si leksionet të cilat zgjasin 3 orë duke u ndërthurur me seminarët, orë laboratorike, detyra kursi, projekte, si dhe leksione të hapura.</p> <p>Sipas RVB metodat e mësimdhënies rishihen në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të arrihen objektivat e mësimnxënies së studentëve dhe mësimi të realizohet në format sa më bashkëkohor.</p> <p>Orër në auditor të formave të mësimdhënies</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Format e mësimdhënies</th> <th>Orët totale në auditor</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione</td> <td>567</td> </tr> <tr> <td>Diploma/Provimi Formimi</td> <td>48</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>615</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>RVB_MSC_BUS_Shqip.pdf</i> <i>Summary Tables MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i></p> | Format e mësimdhënies | Orët totale në auditor | Leksione | 567 | Diploma/Provimi Formimi | 48 | Në total | 615 |
| Format e mësimdhënies | Orët totale në auditor | | | | | | | | |
| Leksione | 567 | | | | | | | | |
| Diploma/Provimi Formimi | 48 | | | | | | | | |
| Në total | 615 | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> | <p>Zhvillimi teknologjik dhe konkurrenca në arsimin e lartë ka ndikuar në përdorimin e formave dhe mënyrave të mësimdhënies të nevojshme dhe efektive në mësimdhënie. Duke qenë master i karakterit shkencor personeli akademik është i orientuar drejt kërkimit dhe formimit shkencor.</p> <p>Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> | | | | | | | | |

| | |
|--|--|
| | <p>Sipas Rregullores së Programeve të ciklit të dytë të studimit, nga këndvështrimi akademik vlerësimi i leksioneve, aplikimeve, laboratoreve, seminareve, ushtrimeve dhe workshopeve realizohet në varësi të orëve që zënë gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> | <p>Personeli akademik gëzon të drejtën e thellimit akademik bazuar në ligjin e arsimit të lartë (Statuti i Universitetit të Epokës, neni 73). Thellimi akademik dhe marrja e eksperiencave të reja ndikojnë në përmirësim të kompetencave didaktike.</p> <p>Institucioni në dokumentat e paraqitura ka depozituar edhe materialin “Dokumentet mbi trajnime”. Sipas RVB, trajnimet e zhvilluara në vitin 2019 u organizuan nga Komisioni i Përherëshëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Këto trajnime u përqëndruan në të mësuarit interaktiv, burime dhe aplikacione dixhitale, mjete të reja vlerësimi, shkëmbimi virtual që konsistonte në mësimdhënie online.</p> <p>Në tabelën 20 paraqitet numri i pjesëmarrësve në projekte kombetare dhe ndërkombëtare, ku pjesëmarrja ndikon në rritje profesionale dhe të kompetencave didaktike.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 13. Documents on Training Events.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Sikurse u përmend më lart personeli akademik është trajnuar dhe është aktiv në realizimin e punimeve shkencore. Personeli akademik është i përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada. Pedagogët janë kompetent në ofrimin dhe shpjegimin e njohurive të nevojshme në fushat e Menaxhimit, sistemeve të informacionit dhe financës.</p> <p>Sipas Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, neni 14, pika c., personeli akademik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit në funksion të promovimit të tij dhe në interes të institucionit, duke nxitur përmirësimin e kompetencave të stafit.</p> <p>Mësimi zhvillohet me metoda që nxisin interaktivitetin e studentëve dhe mendimin shkencor, krijues dhe kritik.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambjentet dhe konkretisht laboratorët, të cilët më anë të infrastrukturës bashkëkohore ndihmojnë në zhvillimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Masteri i Shkencave në Administrim Biznesi ofrohet nga Departamenti i Administrimi të Biznesit, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, të Universitetit Epoka, ka mbështetjen e institucionit për përmirësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p>Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies (Statuti i Universitetit EPOKA, neni 12).</p> <p>Departamenti i Administrimit të Biznesit ka si qëllim të komplotojë studentët me njohuri mbi zhvillimin e biznesit, njohuri të cilat do të aplikohen në biznese dhe OJF. Prioritet për departamentin është të ketë staf të kualifikuar dhe me eksperiencë për tu përshtatur ndryshimeve teknologjike dhe ekonomike, në mënyrë që të përmirësohen format dhe metodat e mësimdhënies dhe përgatitjes së studentëve. Studentët shprehin opinionin e tyre nëpërmjet pyetesorit që plotësojnë në përfundim të semestrit në lidhje me instruktorët e lëndëve si dhe në çdo diskutim me pedagogët gjatë zhvillimit të procesit të mësimin.</p> <p><i>Annex 56. Course Instructor Evaluation Survey.pdf</i> <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 85. Student Satisfaction Survey.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të</p> | <p>Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (Statuti i Universitetit të EPOKES, neni 33), është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave të cilësisë, zbatimit të tyre, dhe për kryerjen e vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore.</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e vëprimitarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësinë kryesore. Sigurimi i Cilësisë është detyrë e Senatit Akademik (Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, neni 77).</p> <p>Një ndër kompetencat e Përgjegjës të njësisë bazë është motivimi dhe nxitja e personelit akademik në ushtrimin e detyrave në procesin mësimor. Gjithashtu kërkon përmirësime dhe rishikime të programeve të studimit.</p> <p>Politika e cilësisë ka në fokus përmirësimin e mësimdhënies nëpërmjet përditësimit dhe zhvillimit të kurrikulës në bashkëpunim me studentët (Politika e cilësisë, pika 4.1).</p> <p><i>Annex 1. Statute of EPOKA (Albanian language).pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 70. Quality Policy.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se metodat e mësimdhënies rishihen në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të arrihen objektivat e mësimnxësis dhe nxitjes së kërkimit shkencor të studentëve dhe mësimi të realizohet në format sa më bashkëkohore.</i></p> <p><i>Përmirësimi i mësimdhënies nëpërmjet përditësimit, zhvillimit të kurrikulës dhe anketës së plotësuar nga studentët rrit cilësinë e formave të mësimdhënies. Lëndët e Programit të studimit MSHAB zhvillohen nëpërmjet formave tradicionale të mësimdhënies, si leksionet të cilat zgjasin 3 orë duke u ndërthurur me seminarët, orë laboratorike, detyra kursi, projekte, si dhe leksione të hapura dhe, nga këndvështrimi akademik vlerësimi i leksioneve, aplikimeve, laboratoreve, seminareve, ushtrimeve dhe workshopeve realizohet në varësi të orëve që zënë gjatë procesit mësimor</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

| | |
|------------------------|--------------------------------------|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
|------------------------|--------------------------------------|




| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> | <p>Format e zhvillimit të provimit, si dhe mënyrat e vlerësimit janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë dhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative.</p> <p>Sipas rregullores së programeve të studimit të ciklit të dytë, vlerësimi i njohurive në module, të studentëve realizohet nëpërmjet sistemit Amerikan të krediteve dhe sistemit European të akumulimit dhe transferimit të krediteve ECTS.</p> <p>Në rregullore përcaktohet se procesi i mësimdhënies konsiston në leksione, projekte, punë laborator, praktika, ushtrime, seminare, etj., të përcaktuara në kurrikul. Një vit akademik përmban 60 ECTS, ky master në total ka 120 ECTS.</p> <p>Në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, në nenin 55, 56 jepet sistemi i vlerësimit me nota. Në nenin 64 të Rregullores përcaktohen format e zhvillimit të provimeve.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Sipas RVB, dhe vizites në institucion, studenti vihet në dijeni në fillim të vitit gjatë javës orientuese për procedurat dhe politikat me të cilat drejtohen studentët. Në Guidën e studentit 2022-2023 dhe Syllabuset e lëndëve dhe RVB përcaktohet se vlerësimi përfundimtar i studentit është një rezultante e vlerësimit gjatë semestrit, detyrat e shtëpisë, provimit të ndërmjetëm, testeve, studimeve të fushës, studimet laboratorike, projektet, frekuentimi i lëndës dhe provimi përfundimtar.</p> <p>Provimet përfundimtare janë me shkrim kurse detyrat dhe projektet e kursit prezantohen. Pedagogu i lëndës jep informacion në lidhje me mënyrën e vlerësimit të njohurive në lëndën respective në javën e parë të semestrit.</p> <p><i>RVB_MSC_BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 35. Student Guide 2022 2023.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe</p> | <p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme si leksione, projekte, punë laborator, raste studimi, ushtrime, seminare, etj.</p> |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|--|---|-------|---|-------|----------------------|--------|---|---------|
| <p>mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> | <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative, në kreun IV, Vlerësimet, sistemi i provimeve dhe kalueshmëria në nenet 55 deri në nenin 59 jepet mënyra e vlerësimit me notë, përcaktimin e statusit të studentit, përlllogaritjen e mesatares, etj.</p> <p>Në tabelën 15, Format e kontrollit të njohurive jepen si më poshtë:</p> <table border="0" data-bbox="595 600 1394 761"> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>0-10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorë)</td> <td>5-20%</td> </tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td> <td>20-40%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar (paper, prezantim)</td> <td>30- 60%</td> </tr> </table> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> | | | | Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive | 0-10% | Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorë) | 5-20% | Testimet gjatë vitit | 20-40% | Provimi përfundimtar (paper, prezantim) | 30- 60% |
| Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive | 0-10% | | | | | | | | | | | |
| Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, laboratorë) | 5-20% | | | | | | | | | | | |
| Testimet gjatë vitit | 20-40% | | | | | | | | | | | |
| Provimi përfundimtar (paper, prezantim) | 30- 60% | | | | | | | | | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se format e zhvillimit të provimit, si dhe mënyrat e vlerësimit janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë dhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative dhe njihen nga studentët dhe studentët njihen me to në fillim të semestrit.</i></p> <p><i>Vlerësimi i njohurive në module, të studentëve realizohet nëpërmjet sistemit Amerikan të krediteve dhe sistemit European të akumulimit dhe transferimit të krediteve ECTS. Vlerësimi përfundimtar i studentit është një rezultante e vlerësimit gjatë semestrit, provimit të ndërmjetëm, testeve, studimeve të fushës, studimet laboratorike, raste studimi, projektet si edhe frekuentimi i lëndës.</i></p> | | | | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> | | | | | | | | |

| | |
|--|---|
| <p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe</p> | <p>Në nenin 59 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative përcaktohet se nota përfundimtare e cdo lënde mund të jetë me provim, laborator, projekt, seminar, etj.</p> |




| | |
|--|--|
| <p>reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Në nenin 62 përcaktohet se lëndët mund të kenë edhe detyrime shlyerjeje, laborator apo aplikim në terren përpara se të hyjnë në provim.</p> <p>Zakonisht provimi bëhet me shkrim por pedagogu i lëndës mund të përcaktojë që provimi të zhvillohet me gojë, në formë projekti ose detyre (neni 64, i Rregullores së FEAS).</p> <p>Në syllabuset e lëndëve përcaktohen forma e vlerësimit të përmbledhura edhe në Tabelën 15, Format e kontrollit të njohurive, të cilat janë: ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, detyra e kursit, detyra laboratorike, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.</p> <p><i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>Vlerësimi i lëndëve është një përmbledhje e detyrimeve të përcaktuara në syllabusin e lëndës dhe të bëra të njohura nga pedagogu që në javën e parë të zhvillimit të lëndës. Forma e zakonshme e provimit final është me shkrim, dhe jo në formë elektronike.</p> <p>Në nenin 44 të Rregullores së programit të studimit të ciklit të dytë konkretizohen përgjegjësitë e studentëve në mbajtjen e qëndrimit etik, profesional dhe përgjegjësinë për shkeljen e rregullave gjatë studimit në programin e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Format e ndryshme të abuzimit apo mashtrimit dhe qëndrimit ndaj tyre janë parashikuar edhe në Direktivën e funksionimit të bordit të provimit.</p> <p><i>Annex 18. Directive On the Functioning of the Exam Board.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> | <p>Për zhvillimin e provimit dhe vlerësimin përfundimtar zbatohet baza ligjore dhe rregullatore. Për çdo lëndë është ndërtuar syllabusi përkatës ku përcaktohen forma e vlerësimit dhe kontrollit të njohurive.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është rezultante e disa formave të kontrollit të njohurive si ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, detyra e kursit, detyra laboratorike, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.</p> |
| | <p><i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i></p> |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Sipas RVB vlerësimi i provimeve krahas pikësve të fituara në provim shoqërohet edhe me komente specifike në lidhje me përgjigjet për të siguruar vlerësim objektov apo për të ndihmuar studentët të cilët do të rijapin provimin.</p> <p>Pedagogët e programit të studimit për kritere të ndryshme vlerësimi përdorin formularë vlerësimi për të vlerësuar kompetencat dhe aftësitë e studentit. Formulari i provimit ndahet me studentët në mënyrë që ata të njihen me të sikrse me komentet përkatëse për provimin.</p> <p>Në këtë drejtim rol të rëndësishëm ka Direktiva e Funkcionimit të Bordit të Provimit. Direktiva përcakton përgjegjësitë e Bordit të Provimit për realizimin e cilësisë së provimeve. Ndër përgjegjësitë është edhe mbikqyrja e provimeve apo testeve të ndërmjetme dhe finale.</p> <p><i>RVB_MSC_BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 18. Directive On the Functioning of the Exam Board.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> | <p>Zhvillimi i provimeve të ndërmjetme apo përfundimtare realizohen nën mbikqyrje të personelit akademik. Personeli akademik me anë të respektimit të rregullores shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p> <p>Bordi i Provimit monitoron nëse provimet e ndërmjetëm dhe finale realizohen sipas skedulit dhe vlerëson masat e marra nga Fakulteti në rast të ndonjë rasti të kopjimit apo plagjiaturës (neni 4, Direktiva e funksionimit të Bordit të Provimit).</p> <p>Dekanati cakton një ekspert për vlerësimin e cilësisë së provimit, për të paktën dy semestra për të vlerësuar cilësinë e lëndëve të përzgjedhura nëpërmjet Formularit të Vlerësimit të Provimit nga ekspertët (neni 7, Direktiva e funksionimit të Bordit të Provimit), duke vlerësuar provimin e ndërmjetëm, final apo riprovimin.</p> <p>Institucioni përdor softwerin Turnitin për kontrollin e Plagjiaturës.</p> <p><i>Annex 18. Directive On the Functioning of the Exam Board.pdf</i> <i>Annex 87. Exam Assessment Form.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Kontrolli i dijeve në provimin final realizohet në kushte të anonimatit nga ana e pedagogut. Fletoret e studentëve janë të pajisur me një kod për cdo student, i cili gjenerohet nga IT, duke siguruar një vlerësim të paanshëm dhe profesional të bazuar në meritë.</p> |




| | |
|---|--|
| | <p>Rezultati i kontrollit të dijeve jepet me notë dhe është konkludim i totalit të pikëve të grumbulluara prej studentit në vlerësimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin final.</p> <p>Studenti vlerësohet për aktivizimin në seminarët, testimet e ndërmjetme, detyrat e kursit, projektet dhe provimi final dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p>Rregullorja e FEAS, neni 53 përcakton detyrimet e studentit për frekuentim të leksioneve, seminareve, laboratorëve, etj. nëse studentit ka shlyer të gjitha detyrimet atëherë ai lejohet të zhvillojë provimin. Studenti këshillohet nga këshilluesi i studentit i cili ndjek ecurinë e studentit. Sikurse u përmënd më lart Bordi i Provimit sigurohet për cilësinë e provimit përfshirë edhe dhënien e rezultatit të provimit në kohë (neni 7, Direktiva e funksionimit të Bordit të Provimit). Finalizimi i notave bëhet brenda 7 ditëve nga provimi përfundimtar i sezonit të provimit dhe dosja e provimeve i dorëzohet kordinatorit të departamentit deri në 10 ditë pas zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p><i>RVB_MSC_BUS_Shqip.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 18. Directive On the Functioning of the Exam Board.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <p>Dekanati i Fakultetit përcakton skedulën e provimeve jo me vonë se dy jave para se të fillojë sezoni i provimit. Sipas RVB dhe vizitës në institucion studentët i marrin notat në sistemin informatik të studentit EIS maksimalisht një javë nga provimi përfundimtar. Studenti me njohjen e vlerësimit ka të drejtë të ankimojë notën.</p> <p>Studenti mund të ankimojë rezultatin e një provimi brenda pesë ditëve (Rregulloret e Programit të ciklit të dytë të studimeve, neni 29) nga data e publikimit të rezultateve duke plotësuar Formularin e ankimimit të notës. Pedagogu i lëndës rishikon paraprakisht provimin nëse ka ndonjë gabim në mbledhjen e pikëve dhe Dekanati merr vendim në lidhje me ankimimin.</p> <p><i>Vizita në institucion</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i> <i>Annex 88. Grade Appeal Form.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p> | <p>Studentët kanë të drejtë të shprehen me ankesë në rast të një vlerësimi që e gjykojnë jo të saktë. Ankimimi bëhet në Zyrën e</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p> | <p>Rregjistrimit brenda 5 ditëve me marrjen e rezultateve (Rregullore e Programit të ciklit të dytë të studimeve, neni 29). Departamenti së cilit i përket lënda i drejtohet Dekanatit me propozim për vendimmarrje pasi është shqyrtuar paraprakisht provimi për gabime në mbledhje pikësh apo vlerësim. Studenti njoftohet për vlerësimin final jo më vonë se 15 ditë nga ankesa.</p> <p><i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se forma e zakonshme e provimit final është me shkrim. Personeli akademik me anë të respektimit të rregullores shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</i></p> <p><i>Pedagogët e programit të studimit për kritere të ndryshme vlerësimi përdorin formularë vlerësimi për të vlerësuar kompetencat dhe aftësitë e studentit. Kontrolli i dijeve në provimin final realizohet në kushte të anonimatit nga ana e pedagogut.</i></p> <p><i>Studentët i marrin notat në sistemin informatik të studentit EIS maksimalisht një javë nga provimi përfundimtar. Studenti me njohjen e vlerësimit ka të drejtë të ankimojë notën.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi III.4 Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka në përbërje lëndë të cilat mundësojnë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive shkencore dhe formojnë me kompetenca shkencore menaxheriale një të diplomuar në fushën e administrimit të biznesit.</p> <p>Programi i studimit ka të përfshira shumë lëndë me zgjedhje duke krijuar mundësi të zgjedhin lëndët të cilat plotësojnë synimet e karrierës së ardhme të studentit. Studentët kanë mbikëqyrësin që luan rolin e këshilltarit në orientimin e zgjedhjes së lëndëve gjë që u shpreh edhe nga studentët. Në këtë drejtim metodologjia e përdorur në zhvillimin e mësimin dhe forma e vlerësimit janë të rëndësishme për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe shkencore.</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>Studentët nxiten dhe motivohen të marrin pjesë në aktivitete shkencore.</p> <p><i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i> <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi është i ndërtuar me lëndë të cilat gjenden edhe në programet e tjera të studimit të këtij drejtimi.</p> <p>Në programin e studimit janë përfshirë lëndë të cilat zhvillojnë aftësi shkencore të veçanta, të nevojshme dhe të rëndësishme për të krijuar një formim bashkëkohor si Shkrimi dhe leximi akademik, Metodatat e kërkimit në biznes, si dhe Marketingu strategjik, etj.. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën angleze.</p> <p><i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p> | <p>Personeli akademik në javën e parë të fillimit të semestrit prezantojnë studentët me syllabusin e lëndëve. Me anë të syllabusit studentët njihen me temat që përmban lënda, objektivat e lëndës, kompetencat që do të fitojnë gjatë studimit të lëndës, literaturën që duhet të studiojnë, etj. Studentët njihen edhe me metodat apo detyrimet për vlerësimin final.</p> <p>Caktimi i mbikqyrësit të cdo studenti jep mundësi të një orientimi profesional të studentëve në zgjedhjen e lëndëve dhe tërheqja e mendimeve të studentëve në lidhje me lëndët dhe aspekte të ndryshme të tyre të jetë e vazhdueshme.</p> <p>Në fund të cdo semestri Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë tërheq mendimet e studentëve cdo fund semestri përpara provimit nëpërmjet një pyetësori për cilësinë e mësimdhënies (neni 38 i Statutit të Universitetit EPOKA).</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 56. Course Instructor Evaluation Survey.pdf</i> <i>Annex 73. Student Satisfaction Survey.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet</p> | <p>Pedagogët që zhvillojnë mësimin në këtë program studimi janë me grada dhe tituj, janë pedagogë relativisht të rinj, të cilët zhvillojnë lëndët mbi bazë kompetencash dhe ekspertize. Pedagogët i zhvillojnë lëndët me kompetencë, duke sjellë eksperiencat më të mira dhe tematika dhe çështjet më të fundit të fushës së administrimit dhe me gjerë.</p> <p>Me anë të formave të mësimdhënies si laboratorët, seminarët, rastet studimore personeli akademik nxit dhe motivon diskutimet me</p> |

| | |
|--|--|
| <p>dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | <p>studentët në lidhje me interpretime, zhvillime idesh duke qëndruar pranë studentëve me orientimin e nevojshëm shkencor. Institucioni nxit me anë të orientimit dhe mësimdhënies rritjen e mobilitetit të studentëve.</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Personeli akademik merr pjesë aktive në aktivitete shkencore ku prezanton punime shkencore dhe studime në fushën e ekonomisë, duke qenë pranë zhvillimeve më të fundit dhe trendeve të ekonomisë. Zhvillimet më të fundit bëhen pjesë e diskutimeve në leksione dhe seminare.</p> <p>Personeli akademik ka realizuar orë të hapura si dhe ka marrë pjesë në leksione, seminare, aktivitete shkencore me qëllim të rritjes së nivelit të tyre profesional shkencor si dhe të pjesëmarrësve. Personeli akademik transmeton informacionin e përfutur si dhe kompetencat gjatë mësimdhënies me studentët.</p> <p><i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p> | <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka karakter shkencor dhe si rrjedhim fokusi është në orientimin drejt kërkimit, interpretimin shkencor dhe studimeve të mikrotezës në këtë drejtim. Në drejtim të studimeve të përparuara kërkimore studentët i ndihon edhe lënda Metodat e kërkimit në biznes. Nuk ka informacion mbi studime të studentëve të financuara nga institucioni. Sipas RVB Zyra e Dekantit të Studentëve nxit dhe ofron mundësinë për studentët për të qenë pjesë e klubeve studentore, të cilat janë të financuar nga Universiteti EPOKA. Departamenti i Administrim Biznesit ka disa klube studentore.</p> <p><i>Annex 59. Directive On Student Clubs.pdf</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka në përbërje lëndë të cilat mundësojnë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive shkencore dhe formojnë me kompetenca shkencore menaxheriale një të diplomuar.</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p><i>Pedagogët i zhvillojnë lëndët me kompetencë, duke sjellë eksperiencat më të mira dhe tematika dhe çështjet më të fundit të fushës së administrimit dhe me gjerë. Personeli akademik merr pjesë aktive në aktivitete shkencore ku prezanton punime shkencore dhe studime në fushën e ekonomisë, duke qenë pranë zhvillimeve më të fundit dhe trendeve të ekonomisë. Zhvillimet më të fundit bëhen pjesë e diskutimeve në leksione dhe seminare. Programi i studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi ka karakter shkencor dhe si rrjedhim fokusi është në orientimin drejt kërkimit, interpretimin shkencor dhe studimeve të mikrotezës në këtë drejtim.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| <p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p> | <p>Sipas Rregullores së programit të ciklit të dytë të studimeve, neni 33, studentët e Programit të studimit Master Shkencor në Administrim Biznesi në semestrin e katërt të studimeve (semestri i fundit në dy vite studimi) mund të nisin të realizojnë mikrotezën. Departamentet propozojnë mbikëqyrësit e tezës dhe një titull për tezën të nënshkruar nga mbikëqyrësi jo më vonë se sa fundi i simestrit të parë, për të cilët merr vendim Dekanati. Pedagogët mbikëqyrës kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Për të orientuar studentët institucioni ka hartuar Guidën e shkrimit të tezës, që udhëzon si për strukturën e ndërtimit të tezës ashtu edhe për shkrimin dhe formatimin. Po në drejtim të shkrimit dhe dorëzimit të mikrotezes ndihmon edhe formati i dorëzimit final të tezës.</p> <p>Rregullorja e FEAS dhe Rregullorja e ciklit të dytë të studimeve përmbajnë informacionin e plotë në lidhje me mikrotezën. Ndërkohë datat e dorëzimit dhe mbrojtjes janë pjesë e kalendarit akademik që bëhen të njohura për studentët</p> |
| | <p><i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i> <i>Annex 66. Thesis-Writing-Guide.pdf</i></p> |

| | |
|--|--|
| | <i>Annex 67. Final Submission of Thesis.pdf</i> |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblylëse. | <p>Këshilltari i studentëve dhe mbikëqyrësi mbështesin dhe ndihmojnë studentët gjatë zhvillimit të mikrotezës me informacione dhe materialet e nevojshme.</p> <p>Rregullorja e programit të ciklit të dytë të studimeve, guida e shkrimit të tezës dhe struktura apo kalendari akademik gjendet në web të universitetit duke qenë publike për të gjithë dhe orientuese gjatë studimit dhe punimit të Mikrotezes.</p> <p><i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i> <i>Annex 66. Thesis-Writing-Guide.pdf</i> <i>Annex 67. Final Submission of Thesis.pdf</i></p> |
| Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | <p>Studentët e programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznes përmbillet me përgatitjen dhe mbrojtjen e Mikrotezës. Në Rregulloren e institucionit dhe Rregulloren e programit të ciklit të dytë të studimeve jepet informacion dhe udhëzim për mbrojtjen e mikrotezës.</p> <p>Në planin mësimor paraqitet si lëndë e detyrueshme Mikroteza. Në mënyrë që një student ti jepet tema e Mikrotezes, studenti duhet të ketë një mesatare të paktën 2.00.</p> <p>Juria përpara së cilës mbrohet Teza propozohet nga Departamenti dhe miratohet nga Dekanati. Pjesë e jurisë është edhe mbikëqyrësi i caktuar për të udhëhequr studentin gjatë punimit të Tezës.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblylës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | <p>Udhëheqësi i Tezës është pjesë e personelit akademik. Ai orienton studentët në bazë edhe të programit të syllabusit të mikrotezës. Mikroteza është pjesë e lëndëve të detyrueshme dhe ka syllabus të vecantë.</p> <p>Pedagogu duke ndjekur edhe syllabusin ndihmon studentin në përcaktimin e metodologjisë, kërkimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre, gjetjen e literaturës, etj. udhëheqësi kujdeset për respektimin e Guidës së shkrimit të tezës dhe miraton paraqitjen e mikrotezës përpara komisionit.</p> <p><i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i></p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Gjatë shkrimit të Mikrotezës studentët orientohen dhe asistohen nga mbikëqyrësi i miratuar nga Dekanati, i cili asiston studentët gjatë kërkimit shkencor, matjeve dhe analizave kërkimore.</p> <p>Studentët mund të përdorin të gjithë infrastrukturës teknologjike të Institucionit për realizimin e detyrave të kursit, projekteve, etj. Studentët shfrytëzojnë burimet e revistave online për nevoja edhe të punimeve të ndryshme gjatë studimeve si burim literature.</p> <p><i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> | <p>Mbrojtja e Mikrotezës zhvillohet përpara një jurie. Pas përfundimit të mbrojtjes juria vlerëson punimet me dyer të mbyllura. Departamenti njofton Fakultetin brenda 3 ditëve që është marrë vendimi për vlerësimin e Mikrotezave me notë. Nëse nota nuk është kaluese, studenti rifillon punën nga fillimi për një temë të re, duke ndjekur guiden e shkrimit të Mikrotezës dhe nën mbikëqyrje të personelit akademik të caktuar në mënyrë që të vlerësohet pozitivisht dhe të diplomohet.</p> <p><i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>Me përfundimin e programit të studimit me sukses, studentët pajisen me diplomë e cila përmban të gjithë elementët e parashikuar në dispozitat në fuqi (Rregullore e FEA, neni 38).</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion diploma dhe suplementi i diplomës së Masterit Shkencor në Administrim Biznes nga Zyra e Rregjistrimit.</p> <p><i>Annex 19. Diploma format MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 20. Diploma supplement MSc BUS.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p> | <p>Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit. Sekretaria disponon dokumentacionin e studentëve gjatë studimeve dhe e arkivon dhe e ruan edhe pas përfundimit të studimeve. Dosjet e studentëve arkivohen sipas viteve dhe programeve të studimit. Institucioni arkivon listat e notave dhe provimet origjinale (Rregullore FEA, neni 67).</p> |
| | <p>Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve realizohet në bazë të parimit të konfidencialitetit. Gjithashtu në rregullore përcaktohen edhe dokumentacioni që lëshohet me</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>kërkesë të studentëve si pjesë e shërbimeve të ofruara për studentët.</p> <p>Në nenin 119 të Statutit të Unieversitetit detajohet dokumentacioni i procesit mësimor. Jepet informacion mbi Rregjistrin themeltar dhe akademik dhe arkivimin e tyre në Arkiven e shtetit sipas kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 2. FEAS Regulation.pdf</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p>GVJ kontaton se puna për realizimin e Mikrotezës fillon në përfundim të semestrit të katërt nëse mesatarja e 3 semestrave është të paktën 2.00.</p> <p>Për të orientuar studentët institucioni ka hartuar Guidën e shkrimit të tezës, që udhëzon si për strukturën e ndërtimit të tezës ashtu edhe për shkrimin dhe formatimin. Po në drejtim të shkrimit dhe dorëzimit të mikrotezes ndihmon edhe formati i dorëzimit final të tezës. Studentët mund të përdorin të gjithë infrastrukturës teknologjike të Institucionit për realizimin e detyrave të kursit, projekteve, etj.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes sëstandardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p> | <p>Institucioni ka në fokus arritjen e objektivave dhe në rastin e Masterit Shkencor të ofrojë njohuri shkencore dhe të motivojë studentët drejt punimeve shkencore. Studentët mund të përdorin të gjithë infrastrukturën teknologjike të Institucionit për realizimin e detyrave të kursit, projekteve, etj. Studentët shfrytëzojnë burimet e revistave online për nevoja edhe të punimeve të ndryshme gjatë studimeve si burim literature.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 68. Infrastructure in service to study programs, logistics and other services towards the community.pdf</i></p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p> | <p>Institucioni përgjegjës për programin e studimit është Fakulteti i Shkencave Ekonomike Administrative institucioni ka lidhur marrëveshje me organizma, institucione dhe ndërmarrje në mënyrë që studentët të përfitojnë njohuri dhe kompetenca shkencore, gjatë realizimit të projekteve dhe rasteve studimore.</p> <p><i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p> | <p>N/A</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>GVJ konstaton se studentët përdorin të gjithë infrastrukturën teknologjike të Institucionit për realizimin e detyrave të kursit, projekteve, etj. Studentët shfrytëzojnë burimet e revistave online për nevoja edhe të punimeve të ndryshme gjatë studimeve si burim literature.</i> ▪ <i>Fakulteti i Shkencave Ekonomike Administrative institucioni ka lidhur marrëveshje me organizma, institucione dhe ndërmarrje në mënyrë që studentët të përfitojnë njohuri dhe kompetenca shkencore, gjatë realizimit të projekteve dhe rasteve studimore.</i> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|--|




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|-------------|-------------|-----------|--|---------|---------|---------|---------|-----|-----|-----|------------|-----|-----|-----|--------|------|-----|------|-----|-----|-----|-----|----------|-------------|-------------|-------------|---|--|--|
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> | <p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit, konstatohet se stafi akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Administrim Biznesi, përmbush kërkesat ligjore, për nivelin e kualifikimit akademik dhe për fushën e ekspertizës. Referuar tabelës 6.3, në Tabelat Përmbledhese MSC BUS.pdf, rezulton se në këtë program studimi, për vitin 22-23, janë të përfshirë 14 pedagogë gjithsej, ndër të cilët 14 janë staf efektiv (PAE) dhe 3 staf me kontratë (PAK).</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 981 758 1041">Tituj/grada</th> <th data-bbox="758 981 965 1041">2022 – 2023</th> <th data-bbox="965 981 1173 1041">2021-2022</th> <th data-bbox="1173 981 1396 1041">2020-2021</th> </tr> <tr> <td></td> <td>PAE/PAK</td> <td>PAE/PAK</td> <td>PAE/PAK</td> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1/-</td> <td>2/-</td> <td>1/1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>3/-</td> <td>4/-</td> <td>3/1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>10/3</td> <td>6/3</td> <td>10/1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>-/-</td> <td>-/-</td> <td>-/-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>14/3</td> <td>12/3</td> <td>14/3</td> </tr> </tbody> </table> | Tituj/grada | 2022 – 2023 | 2021-2022 | 2020-2021 | | PAE/PAK | PAE/PAK | PAE/PAK | Prof.Dr | 1/- | 2/- | 1/1 | Prof.As.Dr | 3/- | 4/- | 3/1 | Dr/PhD | 10/3 | 6/3 | 10/1 | Msc | -/- | -/- | -/- | Në total | 14/3 | 12/3 | 14/3 | <p>Stafi administrativ rezulton te jete në nivel universiteti. (Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf)</p> | | |
| Tituj/grada | 2022 – 2023 | 2021-2022 | 2020-2021 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | PAE/PAK | PAE/PAK | PAE/PAK | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof.Dr | 1/- | 2/- | 1/1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof.As.Dr | 3/- | 4/- | 3/1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Dr/PhD | 10/3 | 6/3 | 10/1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Msc | -/- | -/- | -/- | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Në total | 14/3 | 12/3 | 14/3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |




Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Duke iu referuar planit mesimor si dhe shpërndarjes së ngarkesës, rezulton se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën orare si dhe numrin e lëndëve, në zbatim Udhezimit të brendshëm të Universitetit Epoka, për ngarkesën mësimore. Referuar Dokumentit RVB, Tabela, 10 Plani mësimor si dhe Tabelës 4, tabelës 6.3 si dhe 12.2, 12.3, Ngarkesa totale e stafit akademik të programit të studimit MSHAB, rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:

| Viti | Total orësh ne auditor | PAE | PAK | PAE/PAK (%) |
|-----------|------------------------|-----|-----|-------------|
| 2022-2023 | 624 | 528 | 96 | 85% / 15 % |
| 2021-2022 | 624 | 480 | 144 | 78%/22% |
| 2020-2021 | 624 | 480 | 144 | 78%/22% |

Nga sa me sipër vihet re se ngarkesa mbulohet në masën mbi 78% nga staf efektiv, për tre vitet e fundit akademike.

Annex 69. Directive On the Teaching Load.pdf
Summary Tables MSC BUS.pdf

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin e DVV, në tabelën 6 tek Tabelat Përmbledhëse, konstaton se për tre vitet e fundit, qarkullimi i stafit është 35%, pothuajse i njëjtë ky qarkullim si në PAE dhe në PAK. Referuar DVV si dhe vizitës në institucion, në dosjet e stafit, rezultojnë kontratat e punësimit për stafin akademik si dhe atë joakademik. **GVJ sugjeron që institucioni të orientohet ndaj politikave të burimeve njerëzore që të rrisin qëndrueshmërinë e stafit në këtë program studimi.**

Annex 61. EPOKA Staff Employment Contracts.pdf
Summary Tables MSC BUS.pdf

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsultoi praktika të rekrutimi të cilat, mbështeten në procedura rekrutimi dhe vlerësimi, me kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Kriteret e përgjithshme dhe specifike, propozohen nga Departamenti e miratohen nga Bordi i Administrimit, mbështetur në Rregulloren e Rekrutimit të Universitetit Epoka. Në vijim ato publikohen në webin e instucionit si dhe në duapune.al. Vlerësimi bëhet mbi procedura të ndara në faza, vlerësimi i dosjes, intervista si dhe mbajtja e leksionit të hapur. Aplikimet shqyrtohen nga Komiteti Shkencor i njësisë. Komiteti shkencor ia përcjell vlerësimin e tij, nëpërmjet dekanit, rektorit, i cili propozimin e tij ia përcjell BOA, që merr vendim për emërimin në pozicionin vacant. GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi një praktikë rekrutimi, e cila rezulton me procedurën që është parashikuar në rregulloren e Rekrutimit të stafit në institucion.</p> <p><i>Procedure Rekrutimi.pdf</i> <i>Annex 10. Academic Staff Recruitment Form.pdf</i> <i>Annex 8. Regulation "Staff Recruitment".pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> | <p>Referuar planit mësimor, ky program nuk ka një natyrë specifike teknike, të mbështetur në orë laborator, por pavarësisht natyrës së programit të studimit MSH në AB, nga vizita në institucion dhe nga konsultimi i organigramës së institucionit, rezulton se institucioni garanton staf ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike të programeve të studimit apo të mbështetjes së studentëve gjatë procesit të shkrimit të temave të diplomës.</p> <p><i>Annex 14. Organizational Scheme of EPOKA University.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo</p> | <p>Referuar dosjes së programit të studimit MSH në AB si dhe DVV, GVJ pati në dispozicion informacion për stafin akademik efektiv dhe joefektiv të pesë viteve të fundit, ngarkesa e tyre sipas semestrave, lëndët që mbulojnë, Cv-të e tyre si dhe në zyrën e burimeve njerëzore u konsultuan informacion edhe i dosjeve të tyre, kualifikimet akademike, kontratat, Cv-të, Librezat e punës etj.</p> <p>Për sa më sipër GVJ është e mendimit që informacioni i kërkuar në këtë kriter është i plotë.</p> <p><i>Annex 61. EPOKA Staff Employment Contracts.pdf</i> <i>Annex 5. CVs of the Academic Staff.pdf</i></p> |

| | |
|--|--|
| <p>anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> | <p><i>Annex 8. Regulation "Staff Recruitment".pdf</i> <i>Summary Tables MSC BUS.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton në DVV, Tabelat Përmbledhse (Tab 5), se Institucioni disponon një listë me 39 marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani private, institucione publike si dhe organizata joqeveritare, për mundësimin e praktikave mësimore të studentëve, mbikëqyrjen e tyre si dhe mundësi të punësimit të tyre. Nga takimet me stafin akademik dhe studentët si dhe përfaqësues të zyrave administrative, rezulton se mbarëvajtja e praktikave të studentëve mundësohet mes strukturave të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Aluminit, stafit akademik mbikëqyrës dhe mentorëve në organizatat me të cilat Universiteti Epoka ka marrëveshje.</p> <p><i>Summary Tables MSC BUS.pdf</i></p> <p><i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i></p> |
| <p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> | <p>Nga dokumentacioni i DVV si dhe ai i siguruar në institucion, rezulton se marrëveshjet mes Universitetit Epoka dhe institucioneve/kompanive kanë të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve. Referuar dosjes së praktikës konstatohet se mbikëqyrësi i praktikës në biznes është pjesë e vlerësimit të studentit. Ai është përgjegjës për vlerësimin e studentit gjatë praktikës profesionale. Vlerësimi i tij është pjesë e dosjes individuale të praktikës së studentit.</p> <p><i>Praktikë Mësimore.pdf</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ mbështetur në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit si dhe në vizitën në institucion, vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit MSHAB në Universitetin Epoka, përmbush standardet sasiore dhe cilesore. Institucioni dëshmon se ka numrin e duhur dhe me kualifikimin e duhur e të posaçëm, të stafit akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Institucioni, ndjek praktika rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në rregulloren e institucionit dhe i bën ato transparente. <u>GVJ sugjeron që institucioni të orientohet ndaj politikave të burimeve njerëzore që rrisin qëndrueshmërinë e stafit në këtë program studimi.</u></i></p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X | |

| Standardi IV.2 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>IAL e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe modulet përkatëse. Institucioni shtrihet në një sipërfaqe prej 67.000 m2. Godina ku gjendet Fakulteti Ekonomik dhe zhvillon mësimdhënien e PS, Departamenti i Administrim Biznesit ka hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve (që ka aktualisht. IAL rezulton sipas evidencës infrastrukturare, se disponon 24 klasa seminares, 10 salla leksionesh, 5 laboratorë kompjuterikë dhe 5 laboratorë për lëndë specifike.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme.</p> <p><i>Annex 68. Infrastructure in service to study programs, logistics and other services towards the community.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>GVJ konfirmoi në vizitën e tij në institucion që auditorët ishin të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme tabela, videoprojektor, PC, internet, për një proces efektiv mësimor në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p><i>Annex 68. Infrastructure in service to study programs, logistics and other services towards the community.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e</p> | <p>Për aktivitetet e programit janë gjithashtu në dispozicion pesë laboratorë kompjuterikë të pajisur plotësisht dhe 5 laboratorë</p> |

| | |
|--|---|
| <p>tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>elektronikë. Për të mundësuar një proces efektiv të mësimdhënies dhe mbështetur studentët në veprimtarinë mësimore dhe kërkimore, janë instaluar programe kompjuterike si: Windows: MS Office, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + -MAX, SPSS, WViews , etj.</p> <p>Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit përditëson programet në laboratorët e kompjuterave çdo semestër, bazuar në kërkesat e personelit akademik.</p> <p><i>Annex 68. Infrastructure in service to study programs, logistics and other services towards the community.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucionin konfirmoi që IAL pesë laboratorë të pajisur të teknologjisë së informacionit të cilat janë të pajisura me programet të nevojshme për të realizuar një proces mësimdhënie efektive. Laboratorët rezultojnë se mund të përdoren nga studentët për të përgatitur detyrat dhe punimet e tyre të diplomës.</p> <p><i>Annex 68. Infrastructure in service to study programs, logistics and other services towards the community.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe</p> | <p>Në lidhje me këtë kriter, referuar dokumentacionit por edhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka 39 marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale me një numër të madh kompanish, që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fusha të ndryshme, që mundëson realizimin e praktikës profesionale për studentët e këtij PS.</p> <p><i>Summary Tables MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i></p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| ambulatorë me kapacitetet e nevojshme. | | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ vlerëson se Universiteti Epoka në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ konsultoi syllabuset e lëndëve, vizitoi bibliotekën e institucionit si dhe komunikoi me stafin dhe studentët gjatë vizitës në institucion nga ku rezultoi se në dispozicion të studentëve është vendosur literaturë bazë dhe ndihmëse në shërbim të njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kjo literaturë është në gjuhën shqipe dhe angleze. Burimet e saj gjenden fizikisht si dhe në bibliotekat elektronike që institucioni ka mundur. <i>Annex 40. Directive on the Library.pdf</i> <i>Annex 41. Library Procedures.pdf</i> |
| Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit. | Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar GVJ konstaton që biblioteka e UE ka një fond prej 25000 libra dhe 3712 libra në fushën e biznesit. Librat përditesohen sipas kërkesave që janë bërë nga personeli akademik i departamentit dhe përmes donacioneve, sic rezultoi në RVB. <i>GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e mirë dhe duhet të vazhdojë, pasi mundëson jo vetëm pasurimin e fondeve por dhe përditësimin e literaturës.</i> <i>Annex 39. List of BUS books.pdf</i> |
| Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e | Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi që UE ka anëtarësim të plotë në JSTOR. Çdo anëtar i personelit akademik ka akses në |

| | |
|--|--|
| shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | koleksionet e JSTOR dhe mund të shkarkojnë disa artikuj në mënyrë periodike. Studentët mund të kërkojnë libra në http://lib.epoka.edu.al/ ose mund të kenë akses në koleksionet e JSTOR duke shkuar në http://www.jstor.org/ . |
| Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Referuar evidencave biblioteka ka një fond prej 25000 libra dhe 2000 revista akademike dixhitale. Literatura është bashkëkohore dhe një pjesë e konsiderueshme reflektohet në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Institucioni siguron një numër të konsiderueshëm të teksteve mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse. Numri i titujve në fushën e ekonomisë në bibliotekën e UE është rreth 3700. Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online. Bazuar në kërkesat e personelit akademik fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve. <i>Annex 40. Directive on the Library.pdf</i> <i>Annex 41. Library Procedures.pdf</i> |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Biblioteka ofron kapacitete të pranueshme, me sipërfaqe prej 400 m ² dhe me kapacitet prej 100 vendesh, krijon mundësi të mira shfrytëzimi të hapësirës fizike. GVJ është e mendimit se mundësitë për studentët dhe stafin shtohen nëpërmjet shfrytëzimit të fondit të JSTOR ose të bibliotekave të tjera elektronike që institucioni disponon. |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Aktualisht biblioteka ka pajisje elektronike dhe akses në internet, e cila iu mundëson studentëve shfrytëzimin e fondeve të bibliotekës online. Fondi i bibliotekës është i gjithi digjitalizuar dhe studentët mund ta konsultojnë atë online. <i>[http://lib.epoka.edu.al/]</i> |
| Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që orari i bibliotekës është çdo ditë të javës 08:30 – 12:30/13:30 - 17:30 dhe ditën e Shtunë 9:00-13:00. Oraret e shërbimit janë të përshtatshme për studentët e këtij programi studimi. Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të rishikonin literaturë. <i>[http://library.epoka.edu.al/home.html]</i> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|---|
| <p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p> | <p>GVJ konstatoi në dosjen e vetëvlerësimit të MSH në AB se funksionimi i bibliotekës, pasurimi i saj, cilësia e fondit të librit, është pjesë e analizës vjetore të institucionit.</p> <p>Biblioteka ofron kapacitete të pranueshme, me sipërfaqe prej 400 m² dhe me kapacitet prej 100 vendesh, krijon mundësi të mira shfrytëzimi të hapësirës fizike. GVJ është e mendimit se mundësitë për studentët dhe stafin shtohen dhe behet edhe me e shfrytëzueshme në sajë të fondit të bibliotekave elektronike që institucioni disponon</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ konstaton se kushtet infrastrukturale të bibliotekës janë të vlerësueshme, institucioni ka regjistrim në biblioteka elektronike të akseueshme nga stafi dhe studentët.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në</p> | <p>Sipas dokumentacionit UE përdor një sistem të brendshëm për të menaxhuar të gjitha informacionet. Sistemi Interaktiv Epoka (EIS) është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Çdo student pajisjet me email-in e tij dhe mund të regjistrohet në llogarinë personale të studentit në EIS.</p> |




| | |
|---|--|
| <p>diplomim në programin e studimit.</p> | <p>Nga vizita në UE, ndërfaqja e studentëve jep të gjitha detajet në lidhje me kurset e marra nga studentët, notat, frekuentimin, financat, informacione brenda kampusit, informacione personale të studentëve. Sistemi ofron informacione për vitin aktual akademik.</p> <p><i>Annex 42. EIS GuideLine - Students.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>EIS i siguron personelit akademik disa funksionalitete për të ndjekur dhe menaxhuar rezultatet akademike të studentëve, frekuentimin dhe gjithashtu disa funksione të përgjithshme që i përkasin statusit të stafit. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që EIS menaxhon të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik dhe administrativ në mënyrë hierarkike. Ai është një sistem funksional dhe një instrument efektiv për menaxhimin e informacionit dhe dokumentacionit.</p> <p><i>Annex 43. EIS GuideLine - Lecturer.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>GVJ nga demonstrimi i sistemit, nga takimet me stafin dhe studentët, është e mendimit se EIS siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin informatik EIS.</p> <p><i>Annex 43. EIS GuideLine - Lecturer.pdf</i> <i>Annex 42. EIS GuideLine - Students.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> | <p>Nga takimi me stafin e programit, rezulton se përveç EIS, UE ka dhe një sistem të menaxhimit të mësidhënies (LMS) i cili lehtëson komunikimin interaktiv dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studentëve në kohe reale. Sistemi bazohet në Moodle, mundëson aksesin, koordinimin dhe organizimin e lëndëve në internet. Studentët dhe instruktorët mund të identifikohen në LMS duke përdorur llogarinë zyrtare të emailit dhe përmes platformës mund të kenë komunikime interaktive. Studentët dhe lektorët përdorin gjithashtu Google Classroom në kuadër të platformës Google Suite që aksesohet nga personeli dhe nga studentët me anë të emaileve zyrtare të institucionit.</p> <p>[http://lms.epoka.edu.al/course/index.php?categoryid=388]</p> |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton</p> | <p>Për të gjithë përdoruesit e tij, sistemi i menaxhimit EIS siguron monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik, administrativ dhe</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|
| monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafit akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. EIS u siguron atyre informacione të azhurnuara dhe i ndihmon ata të marrin vendime të informuara bazuar mbi të dhëna. | | |
| Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | GVJ nga navigimi në faqen zyrtare të UE, konstaton se faqja e internetit të UE, paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentët në anglisht. Faqja e UE është e strukturuar sipas hierarkisë që UE ka, duke ofruar informacion deri në nivel departamenti, ku jep informacion më të dedikuar për studentët e PS. <i>[http://www.epoka.edu.al/; http://bus.epoka.edu.al/]</i> | | |
| Konkluzione | <i>GVJ konstaton se UE ka një sistem të integruar të informacionit që siguron informacion të plotë për palë të ndryshme të përdoruesve, si për studentët dhe stafin akademik dhe mbështet bashkërendimin e shumë proceseve akademike dhe administrative me efektivitet</i> | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | |
|---|---|
| Standardi IV.5 | |
| Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe nga takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se institucioni harton një raport financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar për UE. Nga RVB si dhe nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, rezulton se departamenti dhe fakulteti paraqesin kërkesat për buxhet mbështetur në planin strategjik të institucionit si dhe të njësisë. Në vijim hartohet buxheti i IAL i cili kalohet për miratim në BOA. <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i> |

| | |
|---|--|
| | <p><i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i></p> <p><i>Annex 7. BUS Department Strategic Plan 2017-2022.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> | <p>GVJ referuar tabelës 18, në tabelat përmbledhëse, vihet re se institucioni garanton të ardhura nga dy burime, prej tarifave të shkollimit si dhe granteve dhe projekteve. Vihet re se zëri i fundit është shtuar në tre vitet e fundit të raportimit, çfarë demonstron përfshirjen e burimeve të diversifikuara të financimit, sic është sugjeruar edhe në akreditimin e mëparshëm. Bordi i Administrimit aprovon buxhetin vjetor dhe afatmesëm të institucionit bazuar në nevojat e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Pas miratimit të buxhetit nga Bordi Administrativ, Zyra e Financave në bashkëpunim me Administratorin ndjek shpërndarjen dhe zbatimin e buxhetit sipas planit.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> | <p>GVJ konstaton nga DVV se UE auditohet nga audit të jashtëm si pjesë e grupit "Turgut Ozal Education" sh.a në mënyrë të përvitshme. Raporti përmban analizën e të dhënave për shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë dhe institucioneve të përfshira në të, të gjitha hyrjet që lidhen me të ardhurat (grante, tarifat e studentëve) dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ai ofron drejtpërdrejt ose indirekt (duke iu dhënë shërbime të jashtme kompanive). GVJ nuk konsultoi një raport të tillë. GVJ konstaton dhe vlerëson se UE ka ngritur edhe një komision të auditimit të brendshëm të institucionit, për të ndjekur ecurinë vjetore dhe për të ndërmarrë veprimet rregulluese.</p> <p><i>Annex 96. Decision of the Rectorate On the Establishment of the Internal Audit Group.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i></p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> | <p>GVJ konstaton ne sistemin AMS se UE ka depozituar raportet vjetore ku raportohet edhe realizimi i buxhetit të miratuar. Ky raportim paraqitet në nivel departamenti dhe jo në nivel programi.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p> | <p>GVJ konstaton se sipas tabelës 18, të ardhurat në dy vitet e fundit kanë qëndrueshmëri, por ato janë më të larta se 3-5 vite më parë. Rritje identifikohet në të ardhurat nga tarifat si dhe në të ardhurat nga projektet, të cilat deri 4 vite më parë referuar tabelës 18, kanë qenë 0. <u>GVJ sugjeron</u> që institucioni, të ndjek politika promovuese dhe më efektive për programin master i shkencave në AB me qëllim rritjen e numrit të studentëve në këtë program, me qëllim rritjen e të ardhurave nga tarifat e studentëve.</p> <p><i>Tabelat Permbledhese MSC BUS.pdf</i> <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se UE, funksion në respekt të legjislacionit, harton dhe miraton buxhetet vjetore si dhe raporton realizimin e tij. Institucioni i nënshtrohet disa formave të auditimit, të brendshme, dhe të jashtëme, për sigurimin e përdorimit të fondeve në përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|--|




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> | <p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UE ka hartuar statutin dhe rregulloren e universitetit, të cilat përcaktojnë dhe specifikojnë politikën dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ përmes dokumentacionit të dorëzuar konfirmon që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Konkretisht për pranimet në këtë cikël studimi, të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit të publikuar në anglisht nga UE.</p> <p><i>[http://admissions.epoka.edu.al/; http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation; 1.2_statute-of-epoka-university]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikën dhe procedurat që ndjek UE nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Specifikisht të drejtat e studentëve paraqiten në kreun VI të Rregullores në fjalë dhe nenin 117 të statutit.</p> <p><i>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]; pjesa VI; 1.2_statute-of-epoka-university, neni 117]</i> <i>Annex 17. Regulation on student discipline.pdf</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i> <i>Annex 80. Basic regulation.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me</p> | <p>Nga dokumentacioni në DVV si dhe nga takimet në institucion me drejtues të programit në UE ka përcaktuar dy kriteret të veçanta për pranimin në ciklin e parë në PS që ofrohet në anglisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët duhet të zotërojnë një diplomë të shkollës së mesme ose ekuivalente me të, me mesatare minimale të shkollës së mesme 7.00; • Niveli i aftësive në gjuhën angleze B1 në një nga provimet e njohura ndërkombëtarisht; |

| | |
|---|--|
| <p>strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>GVJ konfirmon që kriteret janë hartuar përpara fillimit të vitit akademik dhe janë publikuar në faqen e Zyrës së Pranimit.</p> <p><i>[http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit. Të gjitha informacionet e referuara për pranimin, procedurat dhe dokumentat e regjistrimit, tarifat, bursat dhe transferimin e studimeve janë të publikuara në faqen e internetit të Zyrës së Pranimit të Universitetit EPOKA. Informacioni rezulton se publikohet gjithashtu dhe në rrjetet sociale në faqen e universitetit.</p> <p><i>[http://admissions.epoka.edu.al/cat-bachelor-admissions-1923.html]</i> <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf</i> <i>Annex 80. Basic regulation.pdf</i> <i>Annex 57. Example of a Decision on Student Transfer.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në IAL u informua që Zyra e Pranimit organizon ditët e informimit për maturantët e shkollave të mesme. Maturantët ftohen në kampus dhe marrin informacion të detajuar për universitetin dhe për programe specifike studimi. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maturantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Informacione të gjera mbi programet e studimit janë gjithashtu në dispozicion në internet. Kriteret dhe kërkesat publikohen në faqen e internetit të Zyrës së Pranimit. Informacioni i detajuar mbi kurrikulat e programeve të studimit dhe kurrikulën e Bsc në Administrim Biznesi janë botuar gjithashtu faqen e internetit.</p> <p><i>[http://eis.epoka.edu.al/curricula; http://eis.epoka.edu.al/curricula/21/program; Shënimet gjatë vizitës]</i></p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe</p> | <p>Referuar dokumentacionit si dhe takimit me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë, ata propozojnë kriteret dhe kuotat për PS MSHAB, të cilat miratohen nga senati akademik si dhe nga bordi i administrimit dhe i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Përcaktimi i kriterëve për shtresat e marginalizuara si dhe për kandidatët nga shtete të tjera, mbështetet në udhëzimet e MAS.</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| shtresave të margjinalizuara. | <p>Për sa më sipër, GVJ konsultoi webin e institucionit dhe konstaton se institucioni i publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin në programet e studimit.</p> <p><i>admissions.epoka.edu.al/kat-kriteret-e-pranimit-2487.html</i></p> | | | |
| Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | <p>GVJ mbështetur në dokumentacion konfirmon që kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve janë hartuar në përputhje me aktet nënligjore të MASR. Institucioni pranon në të gjitha programet e tij Bachelor, studentë ndërkombëtarë që plotësojnë kriteret e pranimit dhe ndjekin procedurën e regjistrimit, por ky është një numër i kufizuar studentësh, bazuar në kuotat e pranimit për studentë të huaj të aprovuar nga MASR.</p> | | | |
| Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | <p>Referuar RVB, takimeve në institucion me drejtues dhe studentët e programit si dhe faqes zyrtare të internetit të institucionit, GVJ konstaton se insitucioni ofron informacion të plotë për përfitimin e bursave, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Këto bursa parqiten si bursa merite ose bursa financiare apo përjashtim nga pagesat e tarifave për shtresat në nevojë në përputhje me bazën ligjore në fuqi ose si bursa sociale.</p> <p>Institucioni rezulton të ketë hartuar dhe të ketë funksionale rregulloren e bursave ku sanksionohen llojet e bursave dhe kriteret për përfitimin e tyre.</p> <p><i>Annex 82. Social Scholarships.pdf</i></p> <p><i>Annex 81. Directive On Scholarships.pdf</i></p> <p><i>Annex 84. Merit-based scholarship provided for the 2020-2021 academic year for Second Cycle.pdf</i></p> | | | |
| Konkluzione | <p><i>GVJ, mbështetur në dokumentacion në DVV si dhe nga vizita në institucion, është e mendimit se institucioni, harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit MSHAB. Këto gjenden në rregulloren e institucionit, të fakultetit, të programit si dhe ato publikohen e janë të aksesueshme në web si dhe në sistemin e manaxhimit të informacionit të institucionit.</i></p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> | <p>GVJ konstaton se studentët janë të mire informuar rreth procedurave të përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Këto procedura rezultojnë të jenë të përcaktuara në rregulloret e institucionit. Në nenin 46 të Rregullores së UE, ofrohet informacion i plotë dhe i qartë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Sistemi i menaxhimit të informacionit (ESI) dhe aksesit që studentit ka në të i jep çdo informacion lidhur me këto procedura. GVJ e konstatoi këtë edhe nga pohimet gjatë takimit me studentët.</p> <p><i>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation] Annex 80. Basic regulation.pdf Annex 35. Student Guide 2022 2023.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p> | <p>Nga takimi që GVJ pati, studentët rezultojnë të informuar rreth mundësive për transferim, dhe procedurave që ndiqen. Këto procedura janë të sanksionuara në Rregulloren e UE si dhe në Rregulloren “Për transferimin e studentëve” si dhe publikohen në webin e UE.</p> <p><i>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]; http://epoka.edu.al/mat/directives/13]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> | <p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve rezultojnë të përcaktuara në rregulloren bazë, kreu VII dhe VIII. Po ashtu në syllabusin e çdo lënde, që gjendet në sistemin EIS studentët njihen edhe me mënyrën e vlerësimit në çdo lëndë si dhe nëpërmjet webit të UE.</p> <p>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive. Studentëve iu jepet gjithashtu një udhëzues praktik me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit</p> <p><i>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation]; http://eis.epoka.edu.al/curricula/13188/1/syllabus]</i></p> |




| | | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|--|
| | <i>Annex 35. Student Guide 2022 2023.pdf</i> | | | |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët e programit si dhe me stafin akademik konstaton se ata janë të informuar rreth kriterëve dhe procedurave të punimit të diplomës dhe diplomimit. Studentët informohen nëpërmjet udhëheqësve të tyre si dhe aksesit në udhëzuesin specifik të diplomës që institucioni ka mbi procesin e punimit të diplomës dhe një udhëzues për provimin përfundimtar. <i>Annex 65. Regulation on second cycle study programs.pdf; Annex 80. Basic regulation.pdf; Annex 90. Thesis Examination Report.pdf Annex 66. Thesis-Writing-Guide.pdf Annex 67. Final Submission of Thesis.pdf</i> | | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Nga takimet me përfaqësues të zyrave, rezultojnë se Zyra e Pranimit organizon në mënyrë periodike ditë të hapura ku ftohen studentët potencial në kampus për të marrë informacion të detajuar për universitetin dhe programin specifik të studimit. Pas marrjes së informacionit të përgjithshëm nga Zyra e Pranimit, studentët shoqërohen për të marrë informacion më të detajuar mbi programet e veçanta të studimit nga stafi akademik. GVJ konstaton se UE, ka përgatitur dhe një guidë orientuese që informon studentët për programin e studimit. <i>[Annex Smart_Student_Guide]</i> | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ konstaton se institucioni ofron mundësi informimi për studentët për kriteret e vlerësimit, për detyrimet lëndore, për punimin e tëmës së diplomës si dhe informim për studentët e ardhshëm.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | |
| | | | X | |

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, | Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë dhe komunikimit me Zyrën |

| | |
|---|--|
| <p>organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> | <p>e Pranimeve. Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës të orientimit kryesisht nga përgjegjësi i Departamentit, i cili është dhe koordinator i programit. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. Institucioni ka përgatitur dhe një guidë orientuese që informon studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.</p> <p><i>Annex 92. Course Description.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion u konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit (EIS) studentët marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me lëndët, regjistrimet, orarin dhe notat. Në faqen e internetit të UE publikohet orari mësimor dhe i provimeve, dhe materiale mësimore mbi lëndë të ndryshme (përmes sistemit LMS).</p> <p>GVJ nga konstatimi i sistemit të menaxhimit konfirmoi se informacioni i përcillej studentëve online.</p> <p><i>[http://epoka.edu.al/home-students-timetables-4-395.html];</i> <i>http://lms.epoka.edu.al/</i> <i>Annex 92. Course Description.pdf</i> <i>Annex 4. Syllabuses.pdf</i> <i>Annex 47. The curriculum of the study program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> | <p>Nga takimi që GVJ pati me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni u informua që kjo zyrë oriento studentët drejt tregut të punës. Çdo student që merr pjesë në aktivitete të zhvillimit të karrierës duhet të regjistrohet pranë zyrës përkatëse duke ndjekur hapat e përshkruar në Rregulloren e Zyrës së Këshillimit dhe të Karrierës. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni informon studentët për mundësitë e punësimit. Panairi i Karrierës organizohet çdo vit për të prezantuar tek studentët mundësi të tilla. UE ka vendosur marrëdhënie bilaterale me institucione dhe organizata të ndryshme që mund të mundësojnë punësimin e studentëve</p> |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i> | | | |
| Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Nga takimi me stafin dhe studentët, rezulton se orari mësimor afishohet në faqen e internetit dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Përmes guidës orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. <i>Annex Smart_Student_Guide_2022-2020</i> <i>Annex 94. Lista e Institucioneve jo-arsimore partnere.pdf</i> | | | |
| Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | GVJ konstatoi nga aksesi në system gjatë vizitës si dhe nga takimet me stafin dhe studentët se, cdo pedagog ofron komunikimin nëpërmjet LMS (Sistemit të Menaxhimit të Mësimin) dhe e-mail-it me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë. Studentët mund të aksesojnë systemin nëpërmjet email-it të tyre në sistem ku gjejnë të gjithë informacionin. Studentët mund të aksesojnë sistemin dhe nga jashtë institucionit, pasi platforma është web based. <i>[http://lms.epoka.edu.al/]</i> | | | |
| Konkluzione | <i>GVJ është e mendimit se institucioni informon për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet nëpërmjet sekretarisë mësimore, stafit akademik si dhe LMS.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|---|--|
| Standardi V.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen rregjistrat në lidhje me rregjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për vitin akademik 2022-2023 është 32 studentë ose rreth 14% më i lartë se në vitin akademik 2021-2022, dhe rreth 37.5% më i lartë se në vitin akademik 2020-2021. GVJ kontrolloi rregjistrin themeltar të |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|----------------|-------------|----------------|-------------|----------------|-------------|----------------|-------------|----------------|-------------|
| | <p>studentëve të regjistruar dhe të transferuar si dhe regjistrin e arritjeve akademike me lëndë të zgjedhura rastësisht dhe nuk vërejtë problematika.</p> <p>Sipas Tabelat <i>permbledhese_shqip.pdf</i>, tabela nr.21 dhe vizitës së GVJ-së, në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <table data-bbox="592 607 1034 815"> <tr> <td>Viti 2018-2019</td> <td>28 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2019-2020</td> <td>20 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2020-2021</td> <td>19 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2021-2022</td> <td>28 studentë</td> </tr> <tr> <td>Viti 2022-2023</td> <td>32 studentë</td> </tr> </table> | Viti 2018-2019 | 28 studentë | Viti 2019-2020 | 20 studentë | Viti 2020-2021 | 19 studentë | Viti 2021-2022 | 28 studentë | Viti 2022-2023 | 32 studentë |
| Viti 2018-2019 | 28 studentë | | | | | | | | | | |
| Viti 2019-2020 | 20 studentë | | | | | | | | | | |
| Viti 2020-2021 | 19 studentë | | | | | | | | | | |
| Viti 2021-2022 | 28 studentë | | | | | | | | | | |
| Viti 2022-2023 | 32 studentë | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika për numrin e të regjistruarve, tërheqjeve nga programi, largimeve etj. Numri i studentëve të regjistruar në PS për 5 vitet e fundit akademike është 127. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale. Një pjesë e të dhënave publikohen në raportin vjetor.</p> | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konfirmoi që sekretaria regjistron informacionin mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni hidhet online dhe është i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Sekretaria mësimore nëpërmjet sistemit elektronik që disponon mund të printojë listën e notave për studentët e vet. Sistemi llogarit mesataren për çdo semestër dhe mesataren e përgjithshme e cila jep informacion të plotë dhe të detajuar mbi performancën e studentëve.</p> | | | | | | | | | | |
| | <p><i>Annex 42. EIS GuideLine - Students.pdf</i> <i>Annex 43. EIS GuideLine - Lecturer.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i></p> | | | | | | | | | | |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar, konstaton se proceset mbikëqyrëse si dhe strukturat që kanë përgjegjësinë e kryerjes së proceseve mbikëqyrëse dhe të monitorimit janë të sanksionuara në rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit EIS.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kanë akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve. GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi. GVJ vlerëson pozitivisht, ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm, si njësi që auditon dhe harton raportin e auditit të brendshëm, që i drejtohet rektoratit dhe njësive të audituara, për të identifikuar shmangiet nga planet dhe për të marrë veprimet rregulluese.</p> <p><i>Annex 80. Basic regulation.pdf</i> <i>Annex 44. ICTC Office Services.pdf</i> <i>Annex 45. BUS Action Plan in Response to the Recommendations.pdf</i> <i>Annex 96. Academic Scientific Activities.pdf</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>GVJ konstatoi në RVB, analizë të cilësisë në hyrje dhe në dalje, të studentëve të MSHAB dhe nga vizita në institucion rezulton se Zyra e Planifikimit të karrierës dhe Alumnit, mban të dhëna statistikore rreth të punësuarve, informacion qe gjenerohet nga anketimi i përvitshëm që kjo zyrë bën për të diplomuarit. Këto të dhëna publikohet në faqen e zyratit të institucionit dhe analizohen nga strukturat përkatëse.</p> <p><i>Annex 50. Alumni Survey Questionnaire 2021-2022.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ është e mendimit se institucioni administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit MSHAB, nga pranimi deri në diplomim.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| Standardi V.5 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | GVJ konstaton se Statuti i UE parashikon përfshirjen e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik; Bordin e Etikës; Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; dhe Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore. <i>statute-of-epoka-university.pdf nenet 15/4, 29/2, 34/2, 35/8</i> |
| Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Konstatohet se sipas statutit studentët janë pjesë e vendimarrjes në Senatin Akademik, Bordin e Etikës, Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi gjithashtu se Këshilli Studentor funksionon dhe antarët e tij përçojnë shqetësimet e studentëve në të gjitha trupat vendimmarrëse. Përfshirja e studentëve në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë; është një proces i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe është një instrument që ka ndihmuar në përmirësimin e programeve dhe adresimin më të mirë të nevojave të studentëve. <i>statute-of-epoka-university</i> <i>Annex 59. Directive On Student Clubs.pdf</i> <i>Annex 73. Student Satisfaction Survey.pdf</i> |
| Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e | Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimmarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtpërdrejtë në këtë drejtim shërben pyetësori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. Ky pyetësor menaxhohet në mënyrë të pavarur nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe analiza e rezultateve i shkon Rektorit, i cili duke e |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|---|
| <p>kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>përcjellë në Departament, urdhëron të përpilohet plani i masave përkatëse. GVJ konstatoi këtë proces nëpërmjet dokumentacionit të disponuar dhe takimit me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Annex 73. Student Satisfaction Survey.pdf</i> <i>Annex 72. Course Instructor Evaluation and Action Plan.pdf</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Rregullorja mbi studimet universitare dhe provimet, si dhe udhëzimi mbi provimet mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton përcaktimit e procedurës që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast. GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë.</p> <p><i>Annex 15. Guideline On Examinations.pdf</i></p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ është e mendimit se studentët rezultojnë të përfaqësuar në një sërë komisionesh dhe strukturash vendimarrëse dhe nëpërmjet kësaj pjesëmarrje, institucioni merr feedbackun e tyre për plotësimin e kërkesave që studentët kanë si dhe për rritjen e transparencës ndaj studentëve, për proceset dhe funksionimin e institucionit.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht X</p> |

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> | <p>Nga takimi me përfaqësues të institucionit si dhe studentët rezultojnë se, UE ka funksional strukturën e zyrës së Dekanit të Studentëve, e cila u siguron studentëve mbështetjen, burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet. Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Dekani i studentëve pranon</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>kërkesat e tyre dhe kërkesat vlerësohen nga strukturat përkatëse. Zyra e dekanit të studentëve informon me e-mail studentët për vendimin në lidhje me kërkesën e tyre.</p> <p><i>[statute-of-epoka-university; http://dos.epoka.edu.al/cat-about-us-549.html]</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>Referuar structures organizatove të UE si dhe vizitës në institucion, GVJ është e mendimit se institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, siç janë Zyra e Regjistrimit, Koordinatori i programit, Zyra e Pranimeve, Zyra e Koordinimit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Rregulloret e institucionit parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimarrëse, këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies në mënyrë që ata të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Drejtoritë në shërbim të studentit organizojnë aktivitete si ditët e orientimit, panairët e punës, dhe fushatat e informimit për të promovuar shërbimet e tyre. Zyra e Regjistrimit pajis studentët me Udhëzuesin e Studentit që përmban informacione të hollësishme për jetën e studentit, nga regjistrimi deri në diplomim</p> <p><i>[Smart Student Guide]</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të diplomuar GVJ u informua që zyra ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.</p> <p><i>Publikim nga studenti.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e</p> | <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e Studentëve të diplomuar ka si detyrë gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo disponon një bazë të dhënash mbi studentët e diplomuar në këtë institucion. GVJ konfirmon që zyra zhvillon çdo vit vrojtimin me studentët e</p> |

| | | | |
|---|--|-----------------------------|------------------------------|
| punësimin të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | diplomuar dhe rezultatet i vihen në dispozicion departamenteve dhe publikohen në faqen zyrtare të Zyrës. [http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-.html] | | |
| Konkluzione | GVJ është e mendimit se institucioni ka struktura efektive për orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

| | | | |
|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|--|---|
| Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | GVJ referuar dosjes së vetëvlerësimit si dhe takimeve me stafin akademik dhe atë drejtues të programit, konstaton se institucioni në kushtet e mësimin në distance për shkak të pandemisë, ka hartuar dhe publikuar një udhëzues në nivel institucional për mësimdhënien on-line, për tu përshtatur me kushtet e reja mjedisore mbështetur në metodën hyflex. Përtej pandemisë, në nivel strategjik, UE ka përfshirë në strategjinë e saj 18-22, nxitjen e stafit akademik për të vlerësuar në mënyrë kritike filozofinë dhe metodat e mësimdhënies. Përtej strategjisë GVJ konstaton aktivitete konkrete, sic është përfshirja e UE, në projektin ErasmusValeu-X që ka si qëllim kualifikimin e stafit të IAL-ve shqiptare për |

| | |
|---|---|
| | <p>metodologjinë dhe didaktikën moderne dhe inovatore të mësimdhënies .</p> <p><i>Annex 6. EPOKA University Framework Strategy and Action Plan.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> | <p>Referuar vizitës në institucion dhe takimeve me strukturat drejtuese dhe mbështetëse, GVJ konstaton se strukturat e njësisë bazë, njësisë kryesore përgjegjëse për programin, Zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë në nivel IAL, zbatojnë disa instrumenta të monitorimit të mësimdhënies, si vizita në klasë për vlerësimin e procesit të mësimdhënies, Anketa e vlerësimit të instruktorit, si dhe organizojnë trajnime për stafet akademike për përmirësimin e aftësive inovative në mjedisin e punës.</p> <p><i>Annex 13. Documents on Training Events.pdf</i> <i>Annex 21. Quality Assurance Handbook.pdf</i> <i>Annex 54. Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>Nga takimi me studentët e programit si dhe me stafin e Zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezulton se UE përfshin studentët në forma të ndryshme alternative, sic janë anketa për vlerësimin e instruktorëve nga studentët apo anketa për kënaqësinë e studentit. Këto pyetësorë zhvillohen on-line nëpërmjet sistemit EIS. Pyetësori për vlerësimin e instruktorit është i detyrueshëm dhe zhvillohet para përfundimit të cdo semestri dhe synon përfshirjen sa më të gjerë të studentëve të programit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, format alternative të saj, vlerësimin e dijeve etj.</p> <p><i>Annex 56. Course Instructor Evaluation Survey.pdf</i> <i>Annex 55. Directive Acad & Admin Perfor Assess & Quality Improv.pdf</i> <i>Annex 72. Course Instructor Evaluation and Action Plan.pdf</i> <i>Annex 73. Student Satisfaction Survey.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Gvj konstatoi zyra e SBC, harton një raport vjetor me rezultatet e pyetesorit, i cili shqyrtohet nga Komisioni i SBC në UE, që bën edhe rekomandimet e mëtejshme. Pjesë nga ky raport, përfshihen në raportin e përvitshëm për MAS. Nga kërkimi në web e UE, GVJ konstaton se institucioni publikon aktivitet mbështetëse të strukturave për vlerësimin e brendshëm ose të jashtëm si dhe raportet e akreditimit. Për sa më sipër, shtojcat gjenden në vijim.</p> |

| | | | | |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| | <p><i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Annex 77. 2020-2021-Annual-report-of-PCQA.pdf</i></p> <p><i>http://iqao.epoka.edu.al/home--permanent-commission-on-quality-assurance-0-1408.html)</i></p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Pavarësisht se raporti publikohet në terma të përgjithshëm të gjetjeve, <i>GVJ sugjeron</i> që në këto raporte të identifikohen shembujt dhe praktikat e mira, për promovimin e kulturës së cilësisë, sikurse edhe diskutimin në rang departamenti të gjetjeve kryesore në terma të përgjithshëm si dhe ndarjen me stafin në mënyrë konfidenciale të rezultateve të vlerësimit të secilit pedagog.</p> | | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ lidhur me këtë standard, është i mendimit se UNIVERSITETI EPOKA, ka një politikë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të mësimdhënies.</i></p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi VI.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> | <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludoi që UE ka ngritur struktura dhe miratuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>GVJ referuar DVV, konstaton se këto politika janë të sanksionuara në statutin e UE, në Politikën e Cilësisë së UE si dhe instrumentet dhe metodat parashikohen në Manualin e Sigurimit të cilësisë.</p> <p>UE ka krijuar struktura dhe miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit. Statuti parashikon ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional në neni 14 të tij , ndërsa neni 35 përcakton detyrat e komisionit, dhe nenet 37-38 strukturën dhe kompetencat e Zyrës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>Informacioni në lidhje me strukturat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është publikuar në faqen e IAL.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 21. Quality Assurance Handbook.pdf</i> <i>Annex 22. Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA.pdf</i> <i>Annex 55. Directive Acad & Admin Perfor Assess & Quality Improv.pdf</i> <i>Annex 70. Quality Policy.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> | <p>GVJ konstaton se në UE, sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin Komisionin e SBC, njësitë përbërëse të këtij komisioni (Njësia e sigurimit të brendshëm të Cilësisë, Bordi i Provimeve, Bordi i Vlerësimit të performancës akademike si dhe Komisioni i zhvillimit të Kurikulës), politikën e cilësisë, manualin e sigurimit të cilësisë, ku parashikohen procedurat, udhëzimet dhe instrumentat e sigurimit të cilësisë që komisioni dhe zyrat e tij përbërëse duhet të ndjekin. Në bazë të statutit, institucioni e ka ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili monitorohet nëpërmjet Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Komisionit të Përhershëm në nivel Institucioni dhe auditit të brendshëm. Roli i NJSBC, përfshin vlerësimin periodikë të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësitë kryesore të Universitetit, kryen studime eksploruese për të vlerësuar punësimin e studentëve dhe efektivitetin e programeve të ofruara nga Universiteti, si dhe organizon pyetësorin e studentëve për cilësinë e lëndëve mësimore për secilin program studimi. Njësia varet dhe raporton në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Komisioni përbëhet nga 11 antarë, nga të cilët dy rezultojnë studentë dhe një ekspert i jashtëm. GVJ konstaton se sistemi i sigurimit të cilësisë është i ngritur dhe funksion në mënyrë të efektshme.</p> <p><i>Summary Tables PM BUS.pdf</i> <i>Annex 21. Quality Assurance Handbook.pdf</i> <i>Annex 22. Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA.pdf</i> <i>Annex 55. Directive Acad & Admin Perfor Assess & Quality Improv.pdf</i> <i>Annex 70. Quality Policy.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e</p> | <p>GVJ nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerëimit si dhe nga takimet me safin e KPSC dhe stafin e studentët e programit, konstaton se</p> |

| | | | |
|---|---|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p> | <p>instrumentet e përdorur janë të diversifikuara dhe janë në përputhje me politikat që institucioni ka për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë</p> <p>Këtu konstatohet përdorimi i:</p> <ul style="list-style-type: none"> - formulari i vlerësimit të instruktorit / kursit; - pyetësi me alumni; - formulari i vlerësimit të mësimit; - anketa e kënaqësisë së studentëve; - vlerësimi i publikimeve shkencore dhe veprimtarive akademike; <p>IAL rezultojnë se i është nënshtruar vlerësimit institucional dhe programor periodik. GVJ konstaton se raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm janë të publikuara në faqen e institucionit. GVJ konstatoi që IAL përdor instrumentet e duhur për sigurimin e cilësisë dhe ky proces realizohet me përfshirjen e të gjitha strukturave.</p> <p>[http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html]</p> <p>http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html]</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p> | <p>Krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programeve IAL vlerëson çdo vit performancën e stafit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentët dhe alumni. UE rezultojnë se vlerëson mësimdhënie dhe rezultatet e të nxënies si dhe arritjet në kërkimin shkencor dhe përfshirjen në projekte të stafit. GVJ gjykon se incentivat, aktivitetet dhe instrumentet e aplikuara nga institucioni i shërbejnë krijimit të kulturës së cilësisë në rang institucional.</p> <p><i>Annex 55. Directive Acad & Admin Perfor Assess & Quality Improv.pdf</i></p> | | |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ konstaton se UNIVERSITETI EPOKA, harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSHAB, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |




Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>GVJ konstatoi se IAL përdor mekanizëm formal - sondazhe cdo fund semestri me studentët, vizita në auditore, vlerësimin e performancës, ndryshimin e kurrikulës, etj, për të vlerësuar aspekte të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe takimet me përfaqësues të zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezulton se rezultatet e sondazheve të studentëve dokumentohen dhe analizohen, hartohet në vijim një raport përmbledhës qe përmban rekomandime sipas gjetjeve, duke synuar të adresojë problematikat e hasura nga sondazhet nëpërmjet drejtuesit të njësisë bazë, të njësisë kryesore apo strukturave të tjera që kanë në përgjegjësinë e tyre problematikën e identifikuar.</p> <p>Një mekanizëm tjetër i përdorur, është vlerësimi i performancës së stafit në mënyrë të vazhdueshme, nga Komisioni i vlerësimit të performancës akademike, mbështetur në politikën e cilësisë.</p> <p>Gjithashtu institucioni nëpërmjet një procesi formal, ka ngritur GVB, që ka hartuar RVB dhe ka përgatitur dosjen e vetëvlerësimit për qëllim akreditimi, dokumentacionit të së cilës, i jemi referuar vazhdimisht si GVI, gjatë këtij procesi. Njësia bazë përgjegjëse për PS në MSHAB, harton raporte periodike ku parashikon edhe veprimet rregulluese për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, sic është edhe propozimi për ndryshimin e kurrikulës, referuar më poshtë.</p> <p><i>Annex 91. Curriculum Change Proposal Form.pdf</i> <i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i> <i>Annex 55. Directive Acad & Admin Perfor Assess & Quality Improv.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit,</p> | <p>Referuar RVB, rezulton se raporti i vlerësimit të brendshëm, përmban pikat e forta dhe të dobta të PS MSHAB</p> |

| | |
|---|---|
| <p>motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> | <p>Gjithashtu referuar raportit vjetor të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ai përmban analizën e gjetjeve kryesore dhe rekomandime të lëna për adresimin e problematikave, për strukturat specifike akademike dhe/ ose administrative të UE,</p> <p><i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i> <i>Annex 34.2020-2021-Annual-report-of-PCQA.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga DVV, konstatoi që UE përdor metoda të drejtëpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies. Këto metoda përdoren peridikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese.</p> <p>Për të realizuar vlerësimin e PS konstatohen se përdoren disa metoda të drejtëpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së provimeve nga Bordi i provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit nga njësia bazë, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve etj.</p> <p><i>Annex 18. Directive On the Functioning of the Exam Board.pdf</i> <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 91. Curriculum Change Proposal Form.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e</p> | <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se UE përdor disa instrumenta të tërthortë për të vlerësuar cilësinë e PS si pyetësorin për kursin/instruktorin; pyetësori për kënaqësinë me stafin akademik, pyetësori për kënaqësinë e studenëve me shërbimet, pyetësorin me alumni. Rezulton se vlerësimi i pedagogëve bëhet në fund të çdo semestri, nga llogaria personale e studentëve, përpara fillimit të provimeve. Anketimi ka pyetje në lidhje me përmbajtjen e lëndës, metodat e mësimdhënies, performancën e pedagogut të lëndës dhe stafit ndihmës, shërbimet e ofruara nga universiteti si dhe rekomandimet e studentëve. Rezultatet e të gjitha anketave përpunohen dhe i shërbejnë vlerësimit të mbarëvajtjes së PS. GVJ mbështetur në dokumentacion dhe takimet në IAL konstatoi që këto</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | instrumenta përdoren periodikisht dhe i kanë shërbyer përmirësimit të PS. <i>Annex 72. Course Instructor Evaluation and Action Plan.pdf</i> <i>Annex 56. Course Instructor Evaluation Survey.pdf</i> <i>Annex 48. Report of Alumni Survey 2019-2020.pdf</i> <i>Annex 50. Alumni Survey Questionnaire 2021-2022.pdf</i> <i>Annex 75. Academic Staff Satisfaction Survey.pdf</i> | | | |
| Konkluzione | GVJ është e mendimit se UE monitoron dhe vlerëson përmes KSBC, NJSBC, njësisë bazë dhe kryesore, në mënyrë periodike programin e studimit, MSHAB, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|--|
| Standardi VI.4 | |
| Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | GVJ referuar përbërjes së KPSC, konstaton se ka në përbërje aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. IAL ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë ku përfshihen KPSC, NJSBC, Departamentet dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë. KPSC përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët ka anëtarë nga stafi akademik me kohë të plotë, anëtarë të stafit administrative, ekspert të jashtëm si dhe student. Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. <i>Summary Tables SM BUS.pdf</i> |
| Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton | Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmon që strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në aktet rregullatore specifikohen qartë mënyra e krijimit të këtyre organeve, funksionet kryesore, mandati i antarëve në komision, vendimmarrja dhe njësitë e tjera me të cilat ato ndërveprojnë. GVJ konstaton që detyrat dhe |

| | |
|---|---|
| <p>ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>Annex 1 Statute of EPOKA University.pdf</i> <i>Annex 70. Quality Policy.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> | <p>Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion dhe gjatë vizitës në IAL, GVJ konfirmoi që në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSH në “Administrim Biznesi” janë përfshirë Fakulteti, Departamenti i Administrim Buznesit, antarët e personelit akademik përmes instrumentave të ndryshme të vlerësimit të brendshëm, NJSBC, alumni, studentët dhe kompanitë, nëpërmjet pyetësorëve.</p> <p><i>Annex 56. Course Instructor Evaluation Survey.pdf</i> <i>Annex 50. Alumni Survey Questionnaire 2021-2022.pdf</i> <i>Annex 75. Academic Staff Satisfaction Survey.pdf</i> <i>Annex 74. Department Annual Report 2019-2020.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Nga dokumentacioni i venë në dispozicion dhe takimet e zhvilluara me titullarët, stafin akademik, NJSBC dhe studentët u konstatua se të gjithë aktorët janë përfshirë në proces në mënyrë të pavarur, kanë dhënë mendimet dhe kontributin e tyre përmes zbatimit të instrumentave të ndryshëm. GVJ konstatoi se është respektuar integriteti akademik i stafit gjatë gjithë procesit dhe nuk u identifikua ndonjë diskriminim apo pabarazi. Anketimet zhvillohen elektronikisht dhe në mënyrë anonime.</p> |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>GVJ duke iu referuar përbërjes së KPSC, konstaton se të përfshihet një anëtar/ekspert i jashtëm. Duke ju referuar dokumentacionit, institucioni ka mundur të bëjë pjesë të proceseve të vlerësimit aktorë të jashtëm nëpërmjet përfshirjes në KPSC të tyre, por dhe zbatimit të instrumenteve të ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë rezultatet e anketës së Alumnit dhe të kompanive</p> <p><i>Summary Tables PM BUS.pdf</i> <i>Annex 50. Alumni Survey Questionnaire 2021-2022.pdf</i> <i>Annex 49. Company Satisfaction Survey 2018 - 2019.pdf</i></p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p>GVJ është e mendimit se UE përfshin të gjithë aktorët e brendshëm, staf akademik, njësi kryesore, bazë, KPSC, në sigurimin e cilësisë. Në këto struktura ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të</p> |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>jashtëm. Raporti me gjetjet e trajtura në mënyrë të përgjithshme dhe rekomandimet, publikohen.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi VI.5 | |
|---|---|
| Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ konstatoi se në webin e UE, janë të publikuara dokumentet që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë si: politikën e cilësisë, manualin për sigurimin e cilësisë, rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e KPSC, politikën për përmirësimin e vazhdueshëm të PS, rregulloren mbi funksionimin e bordit të provimeve. si dhe raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm (institucional dhe për çdo program studimi), dhe raportet vjetore të IAL. GVJ konfirmon që IAL mundëson transparencë maksimale për të gjitha procedurat dhe proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë. <i>[http://aeqi.epoka.edu.al/home.html; http://bus.epoka.edu.al/]</i> |
| Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ konstaton se RVB dhe RVJ janë të publikuara në faqen e IAL. Nga vizita në institucion, rezultoi se IAL bën publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësoreve duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale. Aktorët e interesuar njihen me këto raporte përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentave. <i>http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html;</i> <i>Annex 33. Annual Report EPOKA 2021-2022.pdf</i> <i>Annex 72. Course Instructor Evaluation and Action Plan.pdf</i> <i>http://iqao.epoka.edu.al/home--permanent-commission-on-quality-assurance-0-1408.html</i> |
| Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan | GVJ në DVV si dhe gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni harton plane masash dhe ndërmerr aktivitete rregulluese mbi problematikat e dala, referuar analizës së |

| | |
|---|---|
| <p>masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <p>pyetësorëve të studentëve, akreditimit të jashtëm apo edhe nevojës për ndryshim të kurrikulës. Njësitë administrative dhe ato akademike përgatisin gjithashtu plane veprimi në përgjigje të gjetjeve të auditit të brendshëm të Universitetit. Për sa më sipër shihni, evidencat më poshtë që konkretizojnë planet e masave që GVJ konstatoi.</p> <p><i>Annex 45. BUS Action Plan in Response to the Recommendations.pdf</i> <i>Annex 64. Progress Reports concerning the Action Plans in response to the recommendations of Accreditation Board.pdf</i> <i>Annex 72. Course Instructor Evaluation and Action Plan.pdf</i> <i>Annex 79. Decision of the Academic Senate on the Action Plan in Response to the Recommendations left by the Accreditation Board.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>GVJ konstaton se institucioni ka përmbushur një prej sugjerimeve lidhur me hartimin e një raporti të integruar të Komisionit të perhershëm të sigurimit të cilësisë.</p> <p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MAS si dhe raportit KPSC.</p> <p><i>Annex 77. 2020-2021-Annual-report-of-PCQA.pdf</i></p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>GVJ vlerëson se UE, organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit rezultojnë: Përfshirja e stafit në proceset e vlerësimit të brendshëm; Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit; Përfshirja e studentëve në pilotimin e pyetësorëve; Përfshirja e stafit akademik në vlerësimin e performancës.</p> |
| <p>Konkluzione</p> | <p><i>GVJ është e mendimit se proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit PS në MSHAB, janë</i></p> |




| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <i>publike dhe transparente dhe synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së PS MSHAB.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Epoka”

1. Infrastruktura fizike dhe e Teknologjisë së informacionit, cilësore, inovative dhe efektive në shërbim të studentëve dhe stafit akademik
2. Zhvillimi i programit në gjuhën angleze, krijon mundësi për angazhimin e studentëve të huaj dhe rrit mobilitetin e studentëve shqiptar në programe shkëmbimi
3. Staf akademik shqiptar dhe i huaj, me eksperiencë, i motivuar dhe i angazhuar, i orientuar drejt kulturës së cilësisë.
4. Shërbime mbështetëse efektive për stafin dhe studentët
5. Mbështetje financiare për studentët, nëpërmjet bursave të meritës dhe atyre sociale
6. Sistemi dhe strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, efektive. Instrumentet e aplikuara nga institucionit i shërbejnë krijimit të kulturës së cilësisë në rang institucional
7. Aplikimi i programeve softuerike antiplagjaturë, nxit parandalimin e dukurisë.
8. Biblioteka e pasur me fond fizik që azhurnohet dhe biblioteka elektronike të aksesueshme nga stafi dhe studentët

Pika të dobta

1. Qarkullim i lartë i stafit. [(Standardi IV.1, kriteri 3)]
2. Mbulim i ulët i kostove nga të tarifat e studentëve të programit. [(Standardi IV.5 Kriteri 5)]

3. Shumë lëndë me zgjedhje që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të programit.

Rekomandime

1. *GVJ sugjeron që institucioni të orientohet ndaj politikave të burimeve njerëzore që të rrisin qëndrueshmërinë e stafit në këtë program studimi*
2. *GVJ sugjeron që institucioni, të ndjek politika promovuese dhe më efektive për programin master i shkencave në AB me qëllim rritjen e numrit të studentëve në këtë program dhe rritjen e të ardhurave nga tarifat e studentëve*
3. *GVJ sugjeron rritjen e angazhimit dhe pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në projekte ndërkombëtare si dhe në konferenca ndërkombëtare ose kombëtare*
4. *GVJ sugjeron vendosjen e më shumë lëndëve të detyrueshme të profilit që të sigurohen kompetencat e nevojshme*

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Business Administration" provided by the Higher Education Institution "Epoka University"

Strengths and affirmations

1. Quality, innovative and effective physical and information technology infrastructure at the service of students and academic staff
2. The development of the program in the English language creates opportunities for the engagement of foreign students and increases the mobility of Albanian students in exchange programs
3. Albanian and foreign academic staff, experienced, motivated and committed, oriented towards the culture of quality.
4. Effective support services for staff and students
5. Financial support for students, through merit and social scholarships
6. Effective internal quality assurance system and structures. The instruments applied by the institution serve to create a culture of quality at the institutional level
7. The application of anti-plagiarism software programs promotes the prevention of the phenomenon.
8. Rich library with updated physical fund and electronic library accessible by staff and students



Weaknesses

1. High staff turnover [(Standard IV.1, Criteria 3)]
2. Low coverage of costs from program student fees [(Standard IV.5 Criteria 5)]
3. Many electives that can affect the realization of the program's objectives.

Recommendation

1. EEG suggests that the institution orientate itself towards human resource policies to increase the stability of the staff in this study program
2. EEG suggests that the institution follow promotional and more effective policies for the scientific master's program in AB in order to increase the number of students in this program and increase income from student fees
3. EEG suggests increasing the commitment and participation of staff and students in international projects as well as in international or national conferences
4. EEG suggests more compulsory subjects/modules to ensure the necessary competences



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |


